



## **RAPORTI I MONITORIMIT**

### Rritja e aksesit të qytetarëve në gjykatë dhe përmirësimi i procedurave gjyqësore

- I. Monitorimi i seancave gjyqësore të shtyra, frekuentimi i dëshmitarëve dhe palëve
- II. Monitorimi i pagesave të tarifave, pagesave të dëshmitarëve dhe ekspertëve
- III. Monitorimi i ankesave online

**Tiranë, 2013-2014**

## Hyrje

Qeveria dhe institucionet tjera në Shqipëri kanë inkurajuar një sërë reformash për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në përgjithësi dhe vecanërisht transformimin e gjykatave në institucione ku drejtësia jepet në kohë, ku qytetarët kanë akses të barabartë dhe çmimi i këtij akses është i njëjtë për të gjithë. Por megjithatë ende kanë mbetur pa u zhvilluar apo përmirësuar disa aspekte të punës në gjykata të cilat nuk janë aq të dukshme, por ndërkohë ia dalin të frenojnë përmirësimin e dhënies së drejtësisë për qytetarët.

Në Shqipëri korrupsioni në drejtësi është i madh. Në një sondazh të zhvilluar me gjykatësit dy vjet më parë, rreth 24 për qind e tyre e pranonin se sitemi gjyqësor ishte i korruptuar. Por ndërkohë ata deklaruan se në 23 për qind të rasteve të shtyrjes së proceseve gjyqësore, shtyrje të cilat mund të perceptohen si korrupsion nga qytetarët, vinin për shkak të mungesës së dëshmitarëve dhe palëve në procesin gjyqësor.

Ky në fakt nuk është korrupsion, por çështje e menaxhimit dhe adresimit të një problemi i cili nëse zgjidhet mund të ulë në po të njëjtën përqindje kohën e zgjatjes së gjyqeve por edhe më shumë. Mesatarja e kohës së zhvillimit të një procesi në vitin 2012 ka qënë 4.5 muaj dhe kjo kohë ka një rritje progresive që nga viti 2005, pra mund të rritet edhe më tej. Ka gjyqe që zgjasin edhe 2 apo më shumë vite.

Ndërkaq, në vitin 2010 u bë ndërhyrja e fundit nga qeveria për të ndryshuar disa tarifa apo taksa gjyqësore. Tarifat u rritën shumë pa marrë parasysh efektin e tyre tek aksesin në drejtësi. Brenda një kohe të shkurtër këto tarifa u shndërruan në problem të gjyqësorit dhe atakuan fort aksesin e qytetarëve në drejtësi. Natyrisht që më të ndëshkuarit ishin shtresat në nevojë të cilat nuk mund të përballonin tarifa gjyqësore që në disa raste ishin rritur edhe me dhjetë herë.

Tipike ishte taksa gjyqësore prej 3% të vlerës së dëmit të pretenduar kur ai shkonte me shumë se 100000 lekë. Kjo tarifë cenonte të *drejtën e aksesit në gjykatë*, pasi e kushtëzonte aksesin me parapagimin e plotë (100%) të tarifës gjyqësore në masën 3% të vlerës së objektit të padisë dhe nuk parashikonte përjashtime në rastet e pamundësisë financiare.

Ky kufizim i së drejtës së aksesit ishte jo proporcional dhe njëkohësisht diskriminues.

Duke vendosur tarifa të barabarta për të gjithë, krijohet diskriminim i drejtpërdrejtë, thelbësor, për shkak të gjendjes ekonomike, arsimore dhe sociale si dhe mund të krijojë gjithashtu edhe diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë, moshës apo aftësisë së kufizuar.

Në progres raportin e Komisionit European për vitin 2013 përmenden dy prej produkteve të projekteve të mbështetura nga ambasada britanike dhe implementuar nga Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë. Së pari bëhet fjalë për memorandumin e bashkëpunimit mes KLD dhe Ministrisë së drejtësisë për shmangien e mbivendosjes, ku QTIL përgaditi një ekspertizë e cila shërbeu si bazë për këtë memorandum dhe raporti i KE e vlerëson si një bashkëpunim tashmë pa probleme, së dyti lidhur me efektivitetin e ankesave online për gjyqësorin, ku nga progres raporti kërkohej që të vlerësohej ky efektivitet.

QTIL ka implementuar në vitin 2012 ankimimin online dhe menaxhimin dixhital të ankimimeve në ministrinë e Drejtësisë dhe KLD. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 dhe gjashtë muajve të parë të vitit 2013, rreth 25 për qind e ankesave janë kryer në rrugë

digjitale, duke mundësuar zgjedhjen e ankesave të qytetarëve brenda një kohe të shkurtër. Koha e përgjigjes për ankesën në rrugën digjitale është pesë ditë nga 10-360 ditë që ka qënë në rrugë manuale. Kjo ka ndikuar edhe në rritjen e aksesit të qytetarëve në drejtësi. Monitorimi i ankimit online plotëson kuadrin e identifikimit të disa zonave të gjyqësorit përmes të cilave mund të arrihet në përmirësime të ndjeshme të aksesit të qytetarëve në drejtësi, duke shtuar besimin e tyre të drejtësisë si dhe duke adresuar drejt çështje të menaxhimit dhe ndarë ato nga çështje që lidhen me korrupsionin.

## **I. Monitorimi i seancave gjyqësore të shtyra, frekuentimi i dëshmitarëve dhe palëve**

### **1. Metodologjia**

Përgjatë periudhës shtator 2013-mars 2014 janë monitoruar mbi 140 seanca gjyqësore prej të cilave janë përzgjedhur për studim afro 100 prej tyre duke shkarkuar edhe mes këtyre të fundit ato seanca të cilat nuk përmbanin indikatorët e përcaktuar në modulën e monitorimit.

Përzgjedhja konsiston në vecimin e atyre seancave gjyqësore që nuk kanë shërbyer për të mbyllur proceset gjyqësore vetëm në rastet kur ka munduar pala paditëse, duke përfshirë në studim vetëm seancat e shtyra.

Monitorimi është kryer në gjykatën e shkallës së parë në Tiranë.

Qëllimi i monitorimit: Matja e aksesit në drejtësi të qytetarëve në përgjithësi dhe kryesisht shtresave në nevojë. Identifikimi i shkaqeve të zgjatjes së proceseve gjyqësore, problematikave që lidhen me njoftimin e dëshmitarëve dhe palëve në gjyq, vëzhgimin procedurave të pagesave të tarifave nga qytetarët si dhe rimbursimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve. Monitorimi i ankesave online të qytetarëve me qëllim dhënien e shpejtë të përgjigjeve ndaj ankesave, gjetje dhe rekomandime që synojnë përmirësimin e sistemit.

Objektivi i monitorimit: Rritja e aksesit në drejtësi për qytetarët në përgjithësi dhe shtresave në nevojë përmes uljes së tarifave për proceset gjyqësore, përmirësimin të procesit të thirrjes së dëshmitarëve dhe palëve në gjyq, inkurajimit të ekspertëve dhe dëshmitarëve për të marrë pjesë në seancat gjyqësore nëpërmjet pagesave në kohë dhe në kostot reale. Përmirësimi i sistemit të ankesave online dhe rritja e transparencës ndaj publikut përgjatë procesit të menaxhimit të ankesave.

Indikatorët:

- a. Arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore; Nëpërmjet këtij indikatorit synohet të identifikohen dhe të maten faktorët që cojnë në shtyrjen apo zgjatjen e seancave gjyqësore.
- b. Frekuenca paraqitjes së dëshmitarëve dhe palëve në gjyq; Nëpërmjet këtij indikatorit kërkohet të identifikohet kontributi i dëshmitarëve dhe palëve në proces në shtyrjen e proceseve gjyqësore.

c. Arsyet e mungesës së dëshmitarëve dhe palëve në gjyq; Nëpërmjet këtij indikator i synohet identifikimi i arsyeve se pse dëshmitarët apo palët në proces nuk marrin pjesë në sencat gjyqësore

d. Cilësia e shërbimit të thirrjes së dëshmitarëve dhe palëve; nëpërmjet këtij indikator i synohet të vlerësohet rreth performancës së lajmërimit të palëve në gjyq dhe dëshmitarëve

e. Koha e zgjatjes së gjyqeve; përmes këtij indikator kërkohej identifikimi i peshës së faktorëve të ndryshëm në shtyrjen e seancave gjyqësore, sjelljen e këtyre faktorëve në çështje të ndryshme si ato penale apo civile.

f. Llojet dhe shuma e tarifave në gjykatë, (tarifat e procesit gjyqësor dhe ato të procedurës gjyqësore) dhe mundësia e qytetarëve për ti paguar ato; nëpërmjet këtij indikator i synohet të identifikohen ato tarifa të cilat pengojnë aksesin e qytetarëve dhe shtresave në nevojë për të marrë shërbimet e gjykatës

g. Numri i ankesa të qytetarëve për gjyqësorin dhe reagimi i institucioneve të drejtësisë ndaj tyre; nëpërmjet këtij indikator i synohet të matet performanca e administratës së drejtësisë për të përmbushur nevojat e qytetarëve për akses të barabartë dhe të lirë në gjykata.

Tabelë përmbledhëse e të dhënave:


Të dhënat e përfshira në tabelë janë kombinim i monitorimit të frekuentimit të seancave gjyqësore nga dëshmitarët dhe ekspertët (kolona 6), monitorimi mbi arsyet e shtyrjes së seancave gjyqësore (kolona 6,7), monitorimi i aksesit në gjykatë nga qytetarët në nevojë (kolona 6, 7)

Numri	padi		shtyhet		arsyet e shtyrjes, mungon:	te tjera
	penale	civile	po	jo		
1	+		+		dëshmitari	
2	+		+		i akuzuari	eshte ne komisariat, por nuk lajmërohet
3	+		+			pa dokumenta
4	+		+		deshmitari	ne spital
5	+		+		prokurori	
6		+	+		palët	nuk dihet adresa
7		+	+		avokati	
8	+			+		
9		+	+			kërkuar nga palët
10		+	+			kërkuar nga pala
11			+		avokati	
12	+		+			prokurori i papërgaditur

13	+		+			avokat i ri
14	+		+		prokurori	
15		+		+		
16		+	+			
17	+		+		dëshmitarët	janë lajmëruar
18		+		+	palët	
19		+		+		
20	+		+		prokurori	
21		+	+		palët	pa dokumenta
22		+	+		dëshmitari	i lajmëruar
23		+	+		pala paditur	kanë kërkuar shtyrje
24		+	+		pala paditëse	lajmëruar
25		+		+	pala paditëse	
26		+		+	pala paditëse	
27		+	+		eksperti	pa lajmëruar
28		+	+		avokati	
29		+		+	pala paditëse	
30	+		+		gjykatësja	shtyhet tej afateve ligjore
31		+	+		palët	pa lajmëruar
32		+	+		pala e akuzuar	nuk dihet adresa
33		+		+	palët	
34	+		+		pala e akuzuar	nuk dihet arsyeja
35	+		+		prokurori	
36	+		+		prokurori	
37	+		+		dëshmitari	nuk dihet arsyeja
38	+		+			pagesa, mungese dokumentash,
39	+			+	pala paditëse	
40		+	+			kërkohet shtyrje
41	+		+		avokati	
42		+	+		pala e paditur	
43		+	+		taksa gjyqësore	është shtyrë dy herë për taksën
44		+	+		gykatësi	


45	+		+		dëshmitarët	Janë thirrur
46	+			+	Pala paditëse	Janë thirrur
47	+		+		dëshmitarët	Nuk dihet
48	+		+		dëshmitarët	nuk dihet
49	+		+		avokati	
50	+		+			kërkohet nga pala
51	+		+		avokati	
52	+		+		avokati&i padituri	
53		+	+		pa ekspertizë	
54		+	+		prova të reja materiale	
55		+	+		pala e paditur	janë lajmëruar
56	+		+		gjyqtari&prokurori	
57		+		+	pajtim palësh	
58		+	+		dëshmitari	nuk dihet arsyeja
59		+	+		eksperti	
60	+		+		prokurori	
61	+		+			shpallje vendimi
62	+		+		dëshmitarët	do thirren nga mbrojtja
63		+	+		pala e paditur	
64		+	+			konkuzione të paditësit
65	+			+		konkluzione të paditësit
66	+		+			kërkesë e avokatit

Janë monitoruar 66 senca gjyqësore të shtyra, nga këto 31 civile dhe 35 penale




Gjyqet jane shtyre per arsyet e meposhtme:

- Mungesa e deshmitareve, ne 10 raste
- Mungesa e te akuzuarve, ne 7 raste
- Mungesa e prokurorit, në 7 raste,
- Mungojnë të gjitha palët, në 5 raste
- Mungesa e avokatit, në 6 raste,
- Mungesa e gjyqtarit, në 3 raste
- Mungesa e palës paditëse, në 6 raste
- Mungesa e ekspertit, në 2 raste
- Mungesa dokumentash, në 3 raste
- Mospagesa e tarifës, në 3 raste



Ose e shprehur në përqindje, gjyqet janë shtyrë:

- 18 për qind për shkak të mungesës së dëshmitarëve,
- 13 për qind për shkak se mungoi pala akuzuese,
- 13 për qind se mungoi prokurori,
- 10 për qind se munguan të dy palët,
- 12 për qind sepse mungoi avokati,
- 6 për qind për mungesë të gjyqtarit,
- 12 për mungesë të palës paditëse
- 4 për qind për mungesë të ekspertit
- 6 për qind për mungesë dokumentash
- 6 për qind për mungesë të tarifës



Të dhënat e monitorimit tregojnë se 28 seanca gjyqësore kanë dështuar për shkak të mungesës së dëshmitarëve dhe të palëve në seancë gjyqësore. Shkaqet e mungesës listohen më poshtë:

- Mungesa e njoftimit të rregullt të palëve apo dëshmitarëve në 17 seanca.
- Nuk është verifikuar asnjë shkak për mungesën e dëshmitarëve dhe të palëve në 5 raste, megjithëse kishin marrë njoftim të rregullt;
- I pandehuri nuk është shoqëruar nga Komisarjati, ku gjendet i izoluar në 2 seanca gjyqësore;
- Paraqitja e raporteve shëndetësore për të justifikuar mungesën e dëshmitarëve dhe të palëve në 2 seanca gjyqësore;
- Në dy raste nuk ka pasur interesim për mungesat (për shkak të mbylljes së seancës menjëherë për arsye të tjera).





Gjykata e Tiranës ka shtatë ftues. Përmes tyre është e pamundur që të ftosh dëshmitarë apo palë në proces për më shumë se 8000 seanca gjyqësore që e kërkojnë një pjesëmarrje të tillë. Po ashtu sistemi i adresave është ndryshuar vitet e fundit, ndërkohë që referencat janë ende ato të vjetrat. Ftuesit nuk kanë hartë dixhitale përmes të cilave adresat mund të gjenden më lehtë.

Ende adresat janë të përgjithshme. Në këtë mënyrë seancat gjyqësore zvarriten derisa policia mundëson gjetjen e dëshmitarëve. Rast i vecantë është ai gjyqit ndaj ish-komandantit të gardës, Xhavit Xhaferri ku mbi 20 dëshmitarëve nuk iu gjetën adresat e banimit, pavarësisht se për këtë u kërkuu ndihma edhe e Ministrisë së Brendshme edhe e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Zëdhënësja e Gjykatës së Tiranës, thotë se edhe në rastin e procese penale hasim probleme në praninë e dëshmitarëve pasi edhe vetë policia herë pas here nuk e ka të saktë adresën e personit që duhet të marrë pjesë në seancë.

Vetë ftuesit deklarojnë se rreth 60 për qind e adresave të dëshmitarëve apo palëve në proces janë të pasakta.

### **Monitorim i fluksit të çështjeve gjyqësore në gjykatën e Tiranës:**

Duke iu referuar të dhënave të vjetarit statistikor të publikuar nga Ministria e Drejtësisë, konstatohet se në vitin 2011 në gjykatat shqiptare janë regjistruar 11 007 çështje penale, nga të cilat 11,032 çështje penale sipas Kodit Penal (civil) dhe 75 çështje penale sipas Kodit Penal Ushtarak. Kanë përfunduar 8,649 çështje penale, ku 8,590 sipas KPC-së dhe 59 sipas KPU. 2458 çështje nuk janë përfunduar, nga të cilat 2442 sipas KPC-së dhe 16 sipas KPU – së. Çështje të mbartura penale nga gjykata e shkallës së parë për vitin 2011 janë gjithsej 2899. Çështje penale të papërfunduara nga gjykatat e shkallës së parë për vitin 2011 janë 2442 (*shih* vjetari statistikor 2011, fq 17-20).

Lidhur me shpejtësinë e gjykimit të çështjeve penale, për vitin 2011, konstatohet se 4117 çështje janë përfunduar brenda 2 muajve, 3186 çështje për 2-6 muaj, 931 çështje gjyqësore për 6 muaj-1 vit dhe 356 çështje kanë zgjatur më shumë se një vit (*shih* vjetari statistikor 2011, fq 20). Numri i ankimeve në gjykatën e shkallës së parë për çështjet penale për vitin 2011 është 2983 (*shih* vjetari statistikor 2011, fq 32).

Nëse bëhet një analizë e dinamikës së çështjeve penale për tetë vitet 2004-2011, konstatohet se numri i çështjeve të regjistruara në gjykata është rritur paralelisht me numrin e çështjeve të papërfunduara. Duke krahasuar vitin 2004 me vitin 2011, konstatohet se rritja e volumit të çështjeve shkon në 21 %, ndërsa rritja e çështjeve të papërfunduara shkon në 16.3 %.

Të dhënat ndër vite mbi volumin e çështjeve të paraqitura dhe të prapambetura			
Viti	Totali	Të përfunduara	Të papërfunduara
2004	9181	706	2113
2005	8823	6796	2027
2006	9099	7088	2011
2007	9201	6896	2305
2008	10077	7881	2196
2009	9793	7343	2450
2010	11079	8140	2939
2011	11107	8649	2458

Duke iu referuar këtyre treguesve për çështjet civile për tre vitet 2009-2011, konstatohet se sërish tendenca është në rritje – pra numri i çështjeve të regjistruara në gjykata është rritur paralelisht me numrin e çështjeve të papërfunduara. Megjithatë tendenca për rritjen e çështjeve të papërfunduara ka pësuar një rritje shumë të ndjeshme. Duke krahasuar vitin 2009 me vitin 2011, konstatohet se rritja e volumit të çështjeve shkon në 23.3 %, ndërsa rritja e çështjeve të papërfunduara shkon në 69.7 %.

Të dhënat ndër vite mbi volumin e çështjeve civile të paraqitura dhe të prapambetura			
Viti	Totali	Të përfunduara	Të papërfunduara
2009	5897	3949	1948
2010	6432	3732	2700
2011	7271	3965	3306

Ritmi i shtyrjes së seancave ka ndryshuar në vitin e fundit, përmes qasjeve të ndryshme që janë bërë për të përmirësuar funksionimin e gjykatave përmes rishpërndarjes së numrit të gjykatësve në gjykata të ndryshme të vendit, shtimit të hapësirave për salla gjyqi etj. Nga të dhënat e gjykatës së Tiranës të monitoruara deri më 31 mars të vitit 2014 kemi sërish një numër të konsiderueshëm çështjesh të mbartura penale, por ky numër ka shkuar në rënie sidomos për ato çështje që zgjatin mbi një vit.

***Çështje të papërfunduara penale deri në datën 31.03.2014***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	457	51.81 %
61 deri 120	234	26.53 %
121 deri 180	98	11.11 %
181 deri 240	16	1.81 %
241 deri 300	38	4.31 %
301 deri 360	16	1.81 %
361 deri 420	2	0.23 %
421 deri 480	6	0.68 %
481 deri 540	5	0.57 %
541 deri 600	2	0.23 %
601 dderi 660	1	0.11 %
661 deri 720	2	0.23 %
721 ose më shume	5	0.57 %

<b>Totali i çështjeve</b>	<b>882</b>
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	2.61 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	0.57 %

***Çështje të papërfunduara penale deri në datën 31.03.2013***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	287	49.57 %
61 deri 120	117	20.21 %
121 deri 180	80	13.82 %
181 deri 240	11	1.90 %
241 deri 300	31	5.35 %
301 deri 360	16	2.76 %
361 deri 420	9	1.55 %
421 deri 480	8	1.38 %
481 deri 540	6	1.04 %
541 deri 600	2	0.35 %
601 dderi 660	2	0.35 %
661 deri 720	2	0.35 %
721 ose më shume	8	1.38 %

<b>Totali i çështjeve</b>	<b>579</b>
---------------------------	------------

Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	6.39 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	1.38 %

***Çështje të papërfunduara penale deri në datën 31.03.2012***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	223	35.91 %
61 deri 120	170	27.38 %
121 deri 180	86	13.85 %
181 deri 240	15	2.42 %
241 deri 300	38	6.12 %
301 deri 360	28	4.51 %
361 deri 420	12	1.93 %
421 deri 480	8	1.29 %
481 deri 540	12	1.93 %
541 deri 600	3	0.48 %
601 dderi 660	4	0.64 %
661 deri 720	4	0.64 %
721 ose më shume	18	2.90 %

<b>Totali i çështjeve</b>	621
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	9.82 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	2.90 %

***Çështje të papërfunduara penale deri në datën 31.03.2011***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	280	36.99 %
61 deri 120	171	22.59 %
121 deri 180	105	13.87 %
181 deri 240	28	3.70 %
241 deri 300	55	7.27 %
301 deri 360	29	3.83 %
361 deri 420	20	2.64 %
421 deri 480	20	2.64 %
481 deri 540	13	1.72 %
541 deri 600	2	0.26 %
601 dderi 660	10	1.32 %
661 deri 720	8	1.06 %

721 ose më shumë      16                              2.11 %

**Totali i çështjeve**    757  
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë      11.76 %  
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë      2.11 %

Cështjet penale në të gjitha qasjet e tjera kanë një shtyrje në kohë më të shkurtër të seancave për shkak se rrjeti nëpërmjet të cilit kalojnë dosjet gjyqësore janë më institucionale. Kryesisht ato vijnë nga policia në prokurori dhe më pas në gjykatë.

Problemi i mungesës së palëve është më i vogël për shkak se:

- pala e akuzuar është në instuticionet e paraburgimit në pjesën më të madhe të çështjeve;
- ndërsa pala akuzuese përfaqësohet nga prokuroria;
- dëshmitarët janë të identifikuar në adresa përgjatë procesit të hetimit.

Në rastin e shqyrtimit të çështjeve civile ato të papërfunduarat zënë një vend të rëndësishëm. Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ritmi i ndryshimit të çështjeve të papërfunduara në katër vitet e fundit. Pothuajse në cdo vit, rritja e numrit të çështjeve ka cuar edhe në rritjen e kohëzgjatjes së tyre kur flitet për periudha që kalojnë një vit apo më shumë. Megjithatë të dhënat tregojnë se cështjet që shkojnë nga 6 muaj deri në 9 muaj kanë rënë. Po ashtu ka një rënie të lehtë nga viti 2012 e në vijim edhe për cështjet me një kohë më të vogël të procesit nga 1 një ditë deri në 2 muaj, nga 2 muaj deri në 6 muaj.

Kjo tregon se disa reforma të ndërmarra në gjykata lidhur me numrin e gjyqtarëve, shpërndarjen e ngarkesës, kanë dhënë efektivitet të pjesshëm dhe ende nuk janë prekur çështje të tjera të menaxhimit në gjykata që do të ndikonin në uljen e kohës së gjykimit nëpërmjet sigurimit të prezencës së palëve në gjyq e sidomos dëshmitarëve.

Por jo vetëm ndryshimet që vijnë nga vullneti i qeverisë por edhe monitorime apo studime që lidhen me aksesin në drejtësi e kanë anashkaluar problematikën e frekuentimit të gjyqeve nga dëshmitarët dhe palët në proces, avancimin e metodave të njoftimit të tyre, përmirësimin e infrastrukturës në gjykatë në funksion të pagesave të shpejta të dëshmitarëve dhe ekspertëve.

Studimi “Drejt drejtësisë” i OSBE zhvilluar në 2013 teksa trajton zgjatjen proceseve gjyqësore e vë theksin tek arsye të tjera, edhe pse në matjet e saj, mungesa e paleve apo të tretët vonon gjyqet respektivisht në mbi 27 për qind dhe 24 për qind të rasteve.

### ***Çështje të papërfunduara civile deri në datën 31.03.2014***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	1445	26.46 %
61 deri 120	828	15.16 %
121 deri 180	619	11.33 %
181 deri 240	368	6.74 %
241 deri 300	362	6.63 %
301 deri 360	321	5.88 %

361 deri 420	349	6.39 %
421 deri 480	168	3.08 %
481 deri 540	208	3.81 %
541 deri 600	104	1.90 %
601 dderi 660	76	1.39 %
661 deri 720	91	1.67 %
721 ose më shume	522	9.56 %

<b>Totali i çështjeve</b>	5461
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	27.80 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	9.56 %

### ***Çështje të papërfunduara civile deri në datën 31.03.2013***

Kohëzgjatja (në ditë) Numri i çështjeve Përqindja

1 deri 60	2160	26.02 %
61 deri 120	1153	13.89 %
121 deri 180	1267	15.27 %
181 deri 240	609	7.34 %
241 deri 300	629	7.58 %
301 deri 360	526	6.34 %
361 deri 420	424	5.11 %
421 deri 480	306	3.69 %
481 deri 540	239	2.88 %
541 deri 600	140	1.69 %
601 dderi 660	102	1.23 %
661 deri 720	111	1.34 %
721 ose më shume	634	7.64 %

<b>Totali i çështjeve</b>	8300
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	23.57 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	7.64 %

### ***Çështje të papërfunduara civile deri në datën 31.03.2012***

Kohëzgjatja (në ditë) Numri i çështjeve Përqindja

1 deri 60	2006	27.22 %
61 deri 120	1113	15.10 %
121 deri 180	1020	13.84 %

181 deri 240	609	8.26 %
241 deri 300	487	6.61 %
301 deri 360	404	5.48 %
361 deri 420	390	5.29 %
421 deri 480	235	3.19 %
481 deri 540	211	2.86 %
541 deri 600	138	1.87 %
601 dderi 660	119	1.61 %
661 deri 720	101	1.37 %
721 ose më shume	537	7.29 %

<b>Totali i çështjeve</b>	7370
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	23.49 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	7.29 %

#### ***Çështje të papërfunduara civile deri në datën 31.03.2011***

Kohëzgjatja (në ditë)	Numri i çështjeve	Përqindja
1 deri 60	1641	26.88 %
61 deri 120	986	16.15 %
121 deri 180	840	13.76 %
181 deri 240	465	7.62 %
241 deri 300	477	7.81 %
301 deri 360	387	6.34 %
361 deri 420	298	4.88 %
421 deri 480	170	2.79 %
481 deri 540	164	2.69 %
541 deri 600	84	1.38 %
601 dderi 660	87	1.43 %
661 deri 720	82	1.34 %
721 ose më shume	423	6.93 %

<b>Totali i çështjeve</b>	6104
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 360 ditë	21.43 %
Përqindja e çështjeve me kohëzgjatje më shumë se 720 ditë	6.93 %

Zgjatja në kohë e çështjeve civile krahasuar me ato penale në gjykatën e Tiranës tregon se masat e marra nga administrata e drejtësisë të përmendura më sipër nuk kanë pasur të njëjtin efekt si në rastin e çështjeve penale. Çështjet civile që zgjatën më shumë se një vit janë shpesh dhjetë herë më tepër se sa çështjet penale.

Mungesa e dëshmitarëve apo palëve mund të cojë edhe në gjykime të cilat çënojnë aksesin e barabartë të qytetarëve në drejtësi. Gjykatësi mund të japë vendime të cilat më pas është lehtë të apelohe duke zgjatur edhe më shumë kalvarin e procesit gjyqësor. Kemi shqyrtime të çështjes në mungesë, shpallja e vendimit të cilave është e barabartë me një njoftim të palës e cila duhet të paraqitet në gjykatë brenda dy javëve. Nëse nuk paraqitet, gjykata do të zhvillojë procesin në mungesë të palës dhe do të marrë një vendim po në mungesë të saj.

Më poshtë është një vendim i marrënë gjykatën e Tiranës:

*Padites:Golden E.. sh.p.k. I Paditur:Shoqeria "Jeta M... C..."sh.p.k. Objekt:Permbushje detyrimi. Nr.14976.Akti*

**SHPALLJE - GJYKIMI**

*Meqenese nga kjo gjykate jane bere disa here njoftime dhe Pala e paditur Shoqeria "Jeta ..."sh.p.k.nuk eshte paraqitur ne gjykim, behet kjo shpallje gjykimi ne mungese. Ne qofte se: Pala e paditur Shoqeria "Jeta ..."sh.p.k. nuk paraqitet deri me date 21.10.2013. ora 09.00 shqyrtimi i ceshtjes do te behet ne mungese.*

*Kush ka dijeni dhe e njeh Palen e paditur Shoqeria "Jeta ..."sh.p.k. ta njoftoje per tu paraqitur ne gjykate me daten 21.10.2013. ora 09.00 Kjo shpallje behet ne tre kopje ku njera afishohet ne qendren e vendbanimit te fundit te Pales se paditur Shoqeria "Jeta ..."sh.p.k.nr adresen:Rruga Andon Zako Cajupi Nr ... Tirane. nje kopje afishohet ne fasaden e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nje kopje administrohet ne dosje deri me 21.10.2013. ora 09.00.*

*Në qoftë se pala e paditur nuk paraqitet në gjykim, kjo shpallje gjykimi zëvendëson marrjen e njoftimit për gjykim, gjykimi zhvillohet në mungesë me kalimin e dy javëve nga shpallja.*

*Tiranë më 27.09.2013 GJYQTARE A. P*

Në këtë rast, qytetari (pala) nuk ka marrë njoftim nga gjykata për arsye të ndryshme (nuk ka pasur adresë të saktë). Kjo e ndëshkon atë, ndërkohë që përgjegjësia nuk është e tij. Ai mund të mos marrë vesh as për shpalljen e gjykimit në mungesë që ka vlerën e njoftimit dhe si rrjedhim do të përballlet me një vendim gjyqi nga i cili mund të ketë pasoja të ndryshme. Si rrjedhim ai hapin e parë që bën e apelon atë, duke kërkuar një gjykim të drejtë, por ndërkohë rrit kohën e procedimit gjyqësor, shpenzimet për këto procedime dhe zgjat afatin e vendimit, për të cilin janë të interesuar edhe një palë tjetër.

#### **Anex: Aksesi i publikut ne gjykatë:**

Instrumentat e që realizojnë komunikimin brenda gjykatës ndërmjet saj dhe qytetarëve janë eficientë. Përgjatë gjithë orarit zyrtar qëndrojnë të hapura sportelet e Kryesekretarisë, dhe ambiente të pritjes. Ndërkaq funksionon mirë shërbimi i sistemit informatik të gjykatës, referuar edhe numrit të klikimeve që janë regjistruaar në këtë faqe. Përgjatë viti 2013 numri i klikimeve për marrjen e informacioneve të ndryshme ka shkuar në 3.3 milionë.

Ndërkaq cilësia e aksesit publik në gjykatë mbështetet edhe nga monitorë në hyrje të gjykatës dhe në cdo holl të saj që publikojnë listat e gjyqeve dhe oraret e seancave.

Ndërkaq edhe hedhja e hedhja e shortit për ndarjen e çështjeve gjyqësore mes gjykatësve bëhet në mënyrë publike në një sallë gjyqi

#### **Gjetjet:**

1. Gjyqet shtyhen në: 18 për qind të rasteve për shkak se munguan dëshmitarët; 13 për qind për shkak se mungoi pala akuzuese; 13 për qind se mungoi prokurori; 10 për qind se munguan të dy palët; 12 për qind sepse mungoi avokati; 6 për qind se



- mungoi gjyqtari; 12 për qind se mungoi pala paditëse; 4 për qind për mungesë të ekspertit; 6 për qind për mungesë dokumentash; 6 për qind për mungesë të tarifës.
2. Shtyrja e gjyqeve është më e qëndrueshme në rastet e gjyqeve për çështjet civile se sa për ato penale. Kjo për shkak se adresat e dëshmitarëve janë më të stabilizuara, lidhja e tyre me procesin gjyqësor është më madhe për shkak të procesit hetimor, në proces ose përgaditjen e procesit përfshihen shumë struktura si ato të policisë, hetimit dhe gjykatës.
  3. Shtyrja e gjyqeve për shkak të avokatëve është një mit. Avokatët shtyjnë gjyqe vetëm në ato raste kur mungesa e tyre përbën taktikë (rasti i gjyqit të Dritan Dajtit, janë zhvilluar 280 seanca deri tani).
  4. Një numër i konsiderueshëm i gjyqeve shtyhen për shkak të mungesës së prokurorëve
  5. Numri i proceseve gjyqësore për çështje që kalojnë një vit ka ardhur në rritje. Ndërkaq monitorimi ka treguar se çështjet që shkojnë nga 6 muaj deri në 9 muaj kanë rënë. Po ashtu ka një rënie të lehtë nga viti 2012 e në vijim edhe për çështjet me një kohë më të vogël të procesit nga 1 një ditë deri në 2 muaj, nga 2 muaj deri në 6 muaj.
  6. Lajmërimi i dëshmitarëve dhe plaëve mbetet një sfidë për administratën e gjykatave. Rreth 60 për qind e adresave të palës së paditur nuk gjinden, vetëm 40 për qind e tyre janë të sakta.
  7. Administrata e gjykatave nuk shfrytëzon mundësi të tjera për eksplorimin adresave sic është regjistri i votuesve, regjistri i gjendjes civile.
  8. Ftesat e dëshmitarëve shpesh herë bëhen në mënyrë triviale, duke porositur palët në gjyq.
  9. Thirrja e dëshmitarëve dhe palëve mbetet në fund përgjegjësi e gjykatësit i cili nuk ka as kohën dhe as mjetet e nevojshme për të realizuar thirrjen e tyre.
  10. Numri i ftuesve është i pamjaftueshëm dhe ndërkaq ndonjëherë ndodhen edhe në kushtet e konfliktit të interesit. Nuk janë të azhurnuar me mjetet e reja për gjetjen e adresave.
  11. Dëshmitarët apo palët në proces nuk njoftojnë gjykatën për mungesën e tyre duke shkaktuar ndër të thjera edhe rritje të koston së procesit gjyqësor
  12. Në rastet kur ka mungesa të gjyqtarëve apo prokurorëve, kjo nuk njoftohet më përpara prej tyre duke shtuar koston e shpenzimeve për gjyqin të dëshmitarëve apo palëve në proces.
  13. Nuk ka penalitete për ata që nuk paraqiten në seancat gjyqësore.
  14. Nuk ka asnjë inisiativë nga gjykatat apo institucionet e drejtësisë për të mbushur këtë boshllëk ligjor i cili inkurajon frekuentimin e dobët të seancave gjyqësore prej dëshmitarëve.
  15. Njoftimi nëpërmjet shpalljes së gjykimit, edhe pse ligjor, përbën shkelje të së drejtës së qytetarëve për t'u lajmëruar për çështje që lidhen ose trajtojnë interesa që i përkasin atij.

### **Rekomandime:**

1. Gjykatat duhet të reformojnë sistemin e lajmërimit të dëshmitarëve dhe palëve në proces përmes modernizimit të mjeteve të njoftimit dhe përdorimit të mjeteve të reja të komunikimit sidomos të hartave dixhitale
2. Gjykatat duhet të përdorin shërbimet e postës shqiptare në mënyrë më të shpeshtë duke parashikuar një fond për shpenzime për postën në buxhet, përfshirë edhe shpenzimet e shërbimeve të avancuara të postës sic është njoftimi dixhital dhe kontrolli nëpërmjet gjurmimit të njoftimit dhe depozitimit të të dhënave të njoftimit në serverin e aksesueshëm të Postës
3. Gjykatat duhet të konsiderojnë ndarjen e njoftimeve mes Postës apo shërbimeve të tjera private dhe ftuesve për disa çështje që gjykohet se ftuesit mund të kenë konflikt interesi
4. Gjykatat dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor duhet të konsiderojnë seriozisht mundësinë e kontraktimit me një kompani private të thirrjes në tërësi të dëshmitarëve dhe palëve në proces
5. Në kushtet kur ka munguar deri tani një studim rreth dëmit në aksesin e barabartë të qytetarvë në gjykata, frekuentimi i dobët i dëshmitarëve dhe palëve, nevojitet një planifikim tërësor për të gjithë sistemin i buxhetit të nevojshëm për përmirësimin e sistemit të njoftimit, duke mundur kështu uljen e kohës së procesit gjyqësor, daljen në kohë të vendimeve të gjykatës.
6. Gjykatat duhet të hartojnë një rregullore përmes të cilës të parashikohen rastet e shtyrjes së gjyqeve si dhe lajmërimi i palëve për shtyrjen e gjyqit. Sistemi i njoftimeve në gjykatë të jetë i aksesueshëm edhe jashtë gjykatës.

## **II. Monitorimi i pagesave të tarifave, pagesave të dëshmitarëve dhe ekspertëve**

Më poshtë po theksojmë dy prej çështjeve më tipike të monitoruara lidhur me pagesat e tarifave në gjykatë ku konstatohet sjellje të ndryshme në të njëjtën gjykatë nga gjykatës të ndryshëm për të njëjtën çështje.

Shembull 1:

*Përgjatë një procesi civil të iniciuar nga familjarët e viktimave të Gërdecit, gjykatësja Eneida Civici vendosi të përjashtojë nga parapagimi i taksës gjyqësore antarët e njerës nga familjet që kanë humbur njeriun e vet në shpërthimin e Gërdecit. Katër nga paditësit janë fëmijët që kanë humbur babain e tyre në tragjedi dhe kohë më pas edhe nënën. Në kushte të rënda ekonomike atyre u duhej të paguanin një vlerë të taksës së afërsisht 1.2 milion lekëve të reja.*

*Gjyqtarja vendosi të heqë taksën gjyqësore pasi verifikoi se mundësitë parapaguese të familjarëve të viktimës ishin shumë më të ulta sesa vlera e taksës së padisë. Këtë vendimi gjykatësja Civici e mbështeti tek e drejta e aksesit në gjykatë, KEDNJ neni 6, neni 42 i kushtetutës si dhe në vendimin nr 7 dt 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese.*

Ky ishte vendimi i parë i këtij lloji pas vendimit të gjykatës kushtetuese të shkurtit të vitit 2013. Ky vendim mund të shërbentye si precedent edhe për gjykatës të tjerë në raste të ngjashme por në fakt nuk ka shërbyer.

Në një distancë jo më shumë se tre javë mbahet një gjyq tjetër në gjykatën e Tiranës dhe çështja është e ngjashme. Pala paditëse ka synuar të nisë procesin pa kryer pagesën e 3% që shkonte në një vlerë mbi një milionë lekë të reja.

Shembull 2:

*Familja Perzhita inicio çështjen civile me gjyqtar Blerina Muca, paditës Behar dhe Feride Perzhita, me objekti padi shkaktim dëmi.*

*Paditësit kërkojnë nga dëmshpërblehen për humbjen e jetës së familjarit të tyre në një aksident automobilistik në vitin 2011. Pala paditëse ka provuar të nisë procesin pa paguar taksën gjyqësore, por gjykata e ka refuzuar. Gjatë procesit pasi pala e paditur i tregoi fatyrën e depozitimit të tre përqindëshit, gjykata administroi pretendimet e të dyja palëve. Procesi nisi në orën 14.00 dhe përfundoi në 14.30. Ky është një rast kur nuk kanë pasur mundësi të bëjnë pagesën dhe gjyqi nuk ka vazhduar*

Çështjet në fjalë u vecuan nga një grup tjetër çështjesh për të theksuar faktin se gjyqtarët e shkallës së parë pavarësisht vendimit të gjykatës kushtetuese të 28 shkurtit 2013 lidhur me pagesën e tarifave në gjykatë, shpesh nuk ishin në gjendje të marrin vendime të cilat përjashtonin qytetarët në nevojë që kërkonin kompensim dëmi mbi 100.000 milionë lekë nga detyrimi për të paguar taksën gjyqësore që në fillim të procesit.

Vendimi i gjykatës kushtetuse të datës 27 shkurt 2013 trajton pikërisht rastin e pagesës së taksës gjyqësore:

Çdo individ që i drejtohet me padi gjykatës, është i detyruar të parapaguajë taksën mbi aktet (ose “tarifën për shërbime gjyqësore”, sipas udhëzimit nr. 13/2009, supra), e cila caktohet mbi bazën e vlerës së padisë. Megjithatë, Gjykata vlerëson se, në vështrim të neneve të sipërcituara të KPC-së, gjyqtari i zakonshëm nuk

pengohet të hetojë dhe të përjashtojë paditësin nga pagesa e kësaj tarife, në rastet kur ndodhet përpara pamundësisë financiare të tij për të bërë këtë pagesë. Gjyqtari i zakonshëm ka hapësirë për të vlerësuar plotësimin e këtij kriteri procedural për ngritjen e padisë dhe për të bërë përjashtimet rast pas rasti, në mënyrë që të mos pengojë realizimin e të drejtës së aksesit në gjykatë. Sipas dispozitave procedurale civile, në rastet e përjashtimit të individit nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, ku përfshihet edhe taksa mbi aktet, këto shpenzime përballohen nga fondi përkatës i parashikuar në Buxhetin e Shtetit (neni 105/b). Nga ana tjetër, ligji nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, ka përcaktuar një organ shtetëror kolegjal, Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike, detyra kryesore e të cilit është t’u ofrojë ndihmë juridike kategorive të caktuara të individëve, duke kryer shpenzimet përkatëse (nenet 10 dhe 14 të ligjit).

Cështja e pagesave të taksave dhe tarifave gjyqësore është një problem në diskutim të vazhdueshëm përgjatë dymbëdhjetë viteve të fundit. Taksat dhe tarifrat në gjykatë rregullohen nga udhëzime të përbashkëta të ministrisë së drejtësisë dhe ministrisë së Financave. Vlerat e këtyre taksave kanë ndryshuar në kahje të ndryshme. Në tabelën e mëposhtme janë në mënyrë të përmbledhur disa prej ndryshimeve më të ndjeshme që varësisht nga kahu kanë cenuar apo lehtësuar aksesin e qytetarëve në gjykatë e vecanërisht shtresave në nevojë.

*Ndryshimet që ka pësuar tarifa për shërbime gjyqësore*

Lidhja nr. 5 e ligjit nr. 8977/2002 të shfuqizuar	Shtojca 1 e Udhëzimit nr. 13, datë 12.02.2009	Shtojca 1 e Udhëzimit nr. 991/3-2010:
a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: <b>1500 lekë</b>	a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: <b>3000 lekë</b>	a) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore: <b>12000 lekë</b>
b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: <b>1500 lekë</b>	b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: <b>3000 lekë</b>	b) për shkaktim dëmi me vleftë deri 100 000 lekë: <b>12000 lekë</b>
c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: <b>1% e padisë</b>	c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: <b>3000 lekë</b>	c) për shkaktim dëmi me vleftë mbi 100 000 lekë: <b>3% e padisë</b>

Sic shihet nga tabela, tarifa për paditë të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore janë shtuar progresivisht nga viti 2002 kur ishin 1500 lekë për t’u dyfishuar në vitin 2009 në vlerën 3000 lekë dhe katërfishuar në vitin 2010 në vlerën 12.000 lekë. Tarifa për shkaktim dëmi deri në vlerë 100.000 lekë ishte 1500 në vitin 2002. me ndryshimet e udhëzimit të përbashkët të ministrisë së Drejtësisë dhe asaj të Financave në vitin 2009 kjo tarifë u dyfishua duke shkuar në 3000 lekë ndërsa në vitin 2010, tarifa u rrit me katër herë duke kapur shifrën 12000 lekë.

Ndërkaq tarifa për shkaktim dëmi me vlerë mbi 100.000 ishte 1% e padisë në vitin 2002, ndërsa në vitin 2009 ajo pësoi një ulje relative duke u fiksuar në shumën 3000 lekë. Në vitin 2010 kjo tarifë ndryshoi sërish dhe në krahasim me vitin 2002 ajo u trefishua duke shkuar në masën 3% të vlerës së padisë.

Bazuar në kodin e procedurave civile gjykatat mund të ulin taksën gjyqësore në rrethana të veçanta, kur personi i përket një kategorie të caktuar që përjashtohet nga taksat. Por, në vitin 2008, me amendimet që iu bënë ligjit "Për taksat kombëtare" u hoqën disa lehtësi në pagesat gjyqësore që parashikoheshin në variantin e vitit 2002 të këtij ligji për kategori vulnerabel të shoqërisë sic janë personat me aftësi të kufizuara.

Pikërisht taksa e padisë për shkaktim dëmi mbi vlerën 100000 lekë u bë objekt i gjykatës kushtetuese pas padisë që bëri në këtë gjykatë, kreu i gjykatës së Pogradecit.

Vendimi 27.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese pro heqjes së tarifës për shkaktim dëmi por edhe për tarifa të tjera kur e gjykon kështu gjykatësi, lehtësoi ndryshimin e udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë e Ministrisë së Financave nr. 991/3-2010.

Në nëntor nëpërmjet udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së drejtësisë dhe ministrisë së Financave nr.5668, dt.20.11.2013 duke ulur një sërë tarifash dhe ndër të tjera taksën gjyqësore në rastin e padisë për shkaktim dëmi nga 3% e vlerës së padisë në 1% të vlerës së padisë ashtu sic edhe ishte në vitin 2002.

Ndërkohë u ulën në masë të konsiderueshme një numër tarifash të cilat lehtësojnë edhe më tej ngarkesën financiare të qytetarëve që kanë nevojën e gjykatës si dhe lehtësojnë aksesin e tyre në gjykatë dhe shërbimet e saj.

Janë ulur tarifa për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesë ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit nga 400 lekë në 200 lekë; tarifa për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit nga 800 lekë në 200 lekë; tarifa për lëshimin e dëshmisë së gjendjes gjyqësore nga zyra e gjendjes gjyqësore nga 400 lekë në 200 lekë; tarifa për legalizimin e akteve të noterisë nga ministria e Drejtësisë nga 800 lekë në 200 lekë; ajo për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria nga 400 në 200 lekë, tarifa për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria nga 800 lekë në 200 lekë; tarifa për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor nga 400 lekë në 200 lekë.

Po ashtu në udhëzimin e nëntorit të vitit 2013 u ulën edhe tarifa të tjera për kërkesa që paraqiten në gjykatë si ajo për vërtetim fakti nga 800 lekë në 200 lekë; padi për zgjidhje martese nga 9000 në 3000 lekë; padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike nga 12 000 lekë në 3000 lekë.

Më poshtë janë të dy udhëzimet të cilat në fakt shënojnë edhe një dallim në qasjen ndaj aksesit të barabartë në gjykata nëpërmjet trajtimit të tarifave gjyqësore për shërbimet që ajo ofron.

**UDHËZIM Nr.991/3, datë 2.3.2010**

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.13, DATË 12.2.2009 "PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME DHE SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE, MINISTRISË SË DREJTËSISË, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME"

A.

Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria: Masa e tarifës në lekë Në %

1 Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesë ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit **400**

2 Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit **800**

3 Për lëshimin e dëshmisë së gjendjes gjyqësore nga zyra e gjendjes gjyqësore **400**

4 Për legalizimin e akteve të noterisë nga ministria e drejtësisë **800**

5 Për lëshimin e vërtetimit se ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria **400**

6 Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria **800**

7 Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata se kërkuesi nuk është në proces gjyqësor **400**

#### **Tarifa**

1. Kërkesë që paraqitet në gjykatë:

a) për pension ushqimor **0**

b) për vërtetim fakti **800**

2. Kërkesëpadi që paraqiten në gjykatë:

a) padi për zgjidhje martese **9000**

b) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike **12 000**

c) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:

i) me vleftë deri në **100 000 lekë 12 000**

ii) me vleftë mbi **100 000 lekë 3%**

ç) padi për pjesëtim pasurie **12 000**

d) padi për kthim në punë **0**

3. Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës, përveç kërkesës ankimore për paditë e pensionit ushqimor dhe kthimit në punë. **800**

Udhëzimi i mëposhtëm në fakt ia ka dalë që të zgjidhë drejt disa problematika që kishin lindur në gjykata lidhur me aksesin e shërbimeve të saj pas udhëzimit të përbashkët të vitit 2010. Ky udhëzim i ndërtuar më qellim për të ulur deri diku fluksin e madh të ankesave drejt gjykatës, dha një efekt tjetër, duke shtuar në masë të madhe disa pagesa gjyqësore dhe cenuar të drejtat e qytetarëve në nevojë si dhe duke krijuar lehtësi për disa kompani të mëdha, kryesisht ato të sigurimeve e shpesh herë edhe evtë zyrat shtetërore.

#### **UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 5668, datë 20.11.2013**

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 13, DATË 12.2.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR VEPRIME E SHËRBIME TË ADMINISTRATËS GJYQËSORE E MINISTRISË SË DREJTËSISË, SHËRBIMIT PËRMBARIMOR SHTETËROR, PROKURORISË, NOTERISË DHE ZYRËS SË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME”, TË NDRYSHUAR

A.

Tarifa për veprime e shërbime që kryhen nga administrata gjyqësore e prokuroria:

1 Për lëshimin e vërtetimit se personi nuk ka pengesa ligjore për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit **200**

2. Për lëshimin nga gjykata të çdo kopje vendimi e çdo dokumenti që kërkohet nga të interesuarit **200**

3. Për lëshimin e dëshmisë së penalitetit nga zyrat e gjendjes gjyqësore **200**

4. Për legalizimin e akteve të noterisë nga Ministria e Punëve të Jashtme **200**

5. Për lëshimin e vërtetimit së ndaj shtetasit nuk është filluar çështje penale nga prokuroria **200**

6. Për lëshimin e vendimit të pushimit ose të vendimit të mosfillimit të çështjes penale nga prokuroria **200**

7. Për lëshimin e vërtetimit nga gjykata së kërkuesi nuk është në proces gjyqësor  
**200**

Kërkesëpadi që paraqiten në gjykate:

- a) për pension ushqimor **0**
- b) për vërtetim fakti **200**
- c) padi për zgjidhje martesë **3000**
- ç) padi për pavlefshmëri të veprimeve juridike **3000**
- d) padi të rrjedhura nga marrëdhënie kontraktore, si dhe për shkaktim dëmi:
  - I) me vleftë deri **100 000 lekë 3000**
  - II) me vleftë mbi **100 000 lekë 1%**
- dh) padi për përpjesëtim pasurie **3000**
- e) padi për kthim në punë **0**

8. Pranimi i ankimeve kundër vendimeve të gjykatës **200**

Udhëzimi i mësipërm nuk përfshin kosto të tjera që krijohen në gjykatë përmes shërbimeve që nevojiten në seancat gjyqësore sic janë ekspertit, avokati, psikologu. Nëse për psikologët ka një cmim që varion nga lloji i çështjes por rrallë shkon mbi 15000 lekë, cmimi i avokatit është shumë më fleksibël, ndërsa cmimet e ekspertëve konsiderohen shumë të fryra, krahasuar me të dy palët.

Mungesa e një rregullatori brenda profesionit për cmimet, tregu i paqartë lidhur me kërkesën dhe ofertën si dhe ndërhyrja e gjykatës në vendosjen e shpenzimeve gjyqësore krijojnë kosto të larta të procesit gjyqësor. Për çështje të ndryshme ato variojnë nga 20000 lekë deri në 80000 mijë lekë.

Një qytetar duhet të paguajë për afërisht këto tarifa për shpenzime të gjykatës si dhe për kryerjen e veprimeve procedurale.

Pagesa për regjistrimin e Kërkesëpadisë 3000 leke.

Pagesa mbi vlerën e objektit të padisë. 3000 lekë (ose 1% e vlerës së padisë)

Pagesa për shpenzimet paraprake të njoftimit; 250

Pagesa për avokatin, 40000

Pagesa për ekspertin ose psikologun 20000

Shpenzimet që kryhen për përgatitjen e provave: hipotekë, noteri, fotokopje, 5000

Pagesa për vendimin e gjykatës, 200 lekë

Paraqitja e ankimit në vlerën 200 lekë.

Shpenzimet e përmbarimit 3% të vlerës së vendosur nga gjykata. 20000 lekë.

Në total shpenzimet e një qytetari në gjykatë për një çështje civile që lidhet me pronësi, ose divorc mund të arrijë në 90000 lekë. Për një qytetar me të ardhura pranë nivelit të varfërisë, pra afërisht 28000 lekë, marrja e shërbimit gjyqësor ngjan të jetë e pamundur financiarisht në disa raste apo lloje gjykimi edhe kur këtij qytetari i ofrohet ndihma juridike falas (avokati).

Një raport auditimi i Zyrës së Administrimit të buxhetit Gjyqësor, i publikuar në vitin 2012, theksonte se është e domosdoshme unifikimi i pagesës për ekspertë kontabël, autoteknikë, vlerësues të pasurive, ekspertëve të IT dhe psikologë. Aktualisht nuk ka akte nënligjore që përcaktojnë këto shërbime në gjykata. Trupat gjyqësore penale në gjykata të ndryshme, për të njëjtin shërbim vendosin, për tarifa pagese të ndryshme, subjektive dhe shumë të lartë, theksohet në raport.

Monitoruesi nuk hasi në raste të ngjashme por theksoi se përgjatë atyre seancave që u monitoruan dhe rastisën të ishin seancat e fundit të gjyqeve të shtyra, vlerësimet e trupit gjykues për ekspertët ishte i lartë. Në dy raste monitoruesi shënoi se psikologu paguhej 20000 lekë, ndërsa në një rast tjetër ai u pagua 25000 lekë. Po ashtu një ekspert i sigurimeve u pagua 60000 nga pala paditëse pas fitimi të një gjyqi për shkaktim dëmi. Në fakt udhëzimi i Këshillit të Ministrave për shpërblimin e ekspertëve dhe dëshmitarëve i datës 12.12.2012, vë një kufi për pagesën e ekspertëve jo më shumë se 40000 lekë por ku kufi shërben për ato raste kur pagesa bëhet nga gjykata.

### **Pagesa e dëshmitarëve, kosto e thirrjes**

Kosto e thirrjes së dëshmitarëve apo palëve në proces nuk është e përcaktuar qartë, kjo edhe për shkak të vështirësisë së gjetjes së kampionit të matjes dhe ndryshimit të kostonë në varësi të shërbimit që përdoret për njoftim, distancës, numrit të personave që duhen njoftuar për një proces, kohës së lajmërimit etj.

Megjithatë ka një kosto të llogaritur për çështje në vit nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor sipas së cilës arrin në 250 lekë.

### **Republika e Shqipërisë Zyra Administrimit Buxhetit Gjyqësor**

#### **Modeli i Standartit të perkohshëm - orientues të shpenzimeve operative**

<b>000/ leke</b>			
<b>Nr.</b>	<b>Zerat e Analizuar</b>	<b>Viti 2014</b>	<b>Njesia Matese</b>
01	Energji	85	lek/gjyqtar/vit
	<i>Energji Elektrike</i>		
	<i>Karburant për Gjenerator</i>		
02	Kancelari	0.1	lek/ceshtje/vit
03	Leter	0.08	lek/ceshtje/vit
04	Materiale Pastrimi	0.08	lek/m2/vit
05	Mirembajtje Pajisje Elektronike	10	lek/gjyqtar/vit
	Mirembajtje Fotokopje		
	<i>Mirembajtje Kompjuteri</i>		
	<i>Mirembajtje Printeri</i>		
	<i>Mirembajtje Serveri</i>		
	<i>Mirembajtje Fax</i>		
	<i>Mirembajtje Rrjeti (LAN) (Netëork)</i>		
	<i>Mirembajtje programe softëare</i>		
	<i>Faqe interneti (Faqe ëeb)</i>		



06	Shpenzime transporti	145	lek/gjyqtar/vit
07	<b>Shpenzime poste</b>	<b>0.25</b>	<b>lek/ceshtje/vit</b>
08	<b>Shpenzime Telefonia fikse</b>	<b>37</b>	<b>lek/gjyqtar/vit</b>
09	Tonera	0.14	lek/ceshtje/vit
10	Shpenzime mirembajtje ndertese	11	lek/gjyqtar/vit
11	Uje	10.5	lek/gjyqtar/vit

Edhe pse në këtë model orientues të shpenzimeve, kosto e postës mund të mos jetë e njehsuar me koston e njoftimeve, por me kosto të tjera të korrespondencës së gjyqtarit me prokurorinë, ekspertët, palët, avokatët etj. Fakti se kosto e njoftimit nuk është e përfshirë qartë në zërat e koston së gjykatës do të thotë se ajo nënvleftësohet si e tillë, duke e lënë fleksibël, në duart e gjyqtarit, i cili më pas e përfshin në kostot e gjyqit, që i faturohen palës humbëse.

Ka edhe një arsye tjetër se pse është nënvleftësuar kjo kosto: gjykatat përdorin ftuesit e tyre për të kryer lajmërimet. Ftuesit në fakt nuk janë njerëz të specializuar në këtë detyrë dhe mendohet se arrijnë të fitojnë përvojë me kalimin e viteve. Për shkak të vesit të ndryshimit të administratave, edhe ftuesit ndërrohen me ndryshimin e kryetarëve të gjykatave por më shpesh kur ndërrojnë kancelarët. Edhe pse në gjykatën e Tiranës nuk ka të dhëna për ndryshim të shpeshtë të grupit të ftuesve.

### **Trajtimi financiar i dëshmitarëve në gjykatë**

Cështja e rimbursimit të shpenzimeve të dëshmitarit të thirrur në gjyq është trajtuar nëpërmjet udhëzimit Nr. 4, datë 12.12.2012 “Për caktimin e masës së shpenzimeve dhe pagesave të ekspertëve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor”.

“Dëshmitarët në një proces gjyqësor kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për dëshminë e dhënë”, thuhet në udhëzim. Referuar udhëzimit, dëshmitarët duhet të paraqesin në zyrën e financës së gjykatës, biletat e udhëtimit, apo edhe faturat e fjetjes në hotel, për të përfituar më pas dietat. Po ashtu, ata mund të përfitojmë edhe pagesën e ditës së punës që humbin, duke u paraqitur në gjykatë.

Sipas udhëzimit, një dëshmitari i paguhen shpenzimet nëse ai banon në largësi mbi 100 kilometra nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar. “Kur dëshmitari banon në një largësi deri në 100 kilometra nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, mbulimi i shpenzimeve të përfshijë vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifata përkatëse sipas distancës kilometrike të linjës”, thuhet në udhëzim.

Në të njëjtin udhëzim përcaktohet se shpërblimi i dëshmitarit në rastet kur largohet nga vendi i punës është i barabartë me vlerën e pagës ditore të ndërprerë.

#### UDHËZIM

Nr.4, datë 12.12.2012

PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE DHE DËSHMITARËVE GJATË PROCESIT GJYQËSOR

#### UDHËZON

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1. Masa e shpenzimeve të dëshmitarëve dhe pagesës së ekspertëve pjesëmarrës në séance

gjyqësore të përcaktohet sipas rregullave të këtij udhëzimi.

2. Çdo vit, gjykata e rrethit gjyqësor publikon listën e ekspertëve të licencuar dhe përditëson listën, në rastet kur autoritetet licencuese marrin masa administrative të pezullimit të licencës.
3. Gjukata thërret ekspertë të licencuar, të përcaktuar në listën që ajo disponon.
4. Në rast se në listë nuk figurojnë ekspertë në fushën e kërkuar ose kur asnjë nga ekspertët që figuron në listë nuk është i disponueshëm, Gjukata thërret ekspertë të tjerë, referuar veçantisë së fushës së kërkuar.
5. Dëshmitarët në një proces gjyqësor kanë të drejtën e mbulimit të shpenzimeve për dëshminë e dhënë.

## II. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE DHE PAGESAVE TË EKSPERTËVE

1. Caktimi i shpenzimeve që u takojnë ekspertëve bëhet në bazë të kushteve të mëposhtme:

- a) Kur eksperti banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, trajtimi financiar i tij përfshin vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.
  - b) Kur eksperti banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të kryer ekspertizën, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:
    - i) Dietë ditore, jo më shumë se 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë në ditë, kur ekspertiza zgjat më shumë se një ditë. Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë;
    - ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 000 (tremijë) lekë, për çdo natë;
    - iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifapërkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.66, datë 27.2.2007 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.
2. Paga për punën e kryer për ekspertimin nga eksperti i licencuar nuk mund të tejkalojë shumën 40 000 (dyzetmijë) lekë.

## III. KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHPENZIMEVE TË DËSHMITARËVE

1. Caktimi i shpenzimeve, që u takon dëshmitarëve, bëhet, si më poshtë vijon:

- a) Kur dëshmitari banon në një largësi deri në 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, mbulimi i shpenzimeve të përfshijë vetëm shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifapërkatëse sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”.  
10611
  - b) Kur dëshmitari banon në një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, atij i përballohen shpenzimet e mëposhtme:
    - i) Dietë ditore, në masën jo më shumë se 2 500 (dymijë e pesëqind) lekë në ditë;
    - ii) Shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitur nga hoteli e të shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3000 (tremijë) lekë, për çdo natë;
    - iii) Shpenzimet e transportit, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, të miratuar me vendimin nr.307, datë 20.7.1992 të Këshillit të Ministrave “Për tarifapërkatëse të transportit të udhëtarëve”.
  - c) Kur dëshmitari largohet nga vend i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga dëshmitari me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës.
2. Nuk gëzojnë të drejtën e pagesës për dëshmitë e dhëna të dënuarit gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

## IV. SHPENZIME TË VEÇANTA

Pagesat e përkthyesve të caktohen në bazë të udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe

të Ministrisë të Financave, nr.3165, datë 12.5.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifave të pagesës së përkthyesve të jashtëm dhe tarifave të përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, në bazë faqesh. Në rast se përkthyesit do të thirren për t’u paraqitur në gjykatë për të kryer shërbimet e tyre, përveç pagesës, u mbulohen edhe shpenzimet ditore në të njëjtën masë, referuar ekspertëve dhe dëshmitarëve.

#### V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Dokumenti tatimor, për efekt të këtij udhëzimi, do të konsiderohet çdo biletë transporti e miratuar nga Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe çdo faturë e thjeshtë apo me TVSH, e cila detyrimisht duhet të shoqërohet me kupon tatimor.
2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij udhëzimi.

Disa nga përfitimet e dëshmitarit të përfshira në udhëzim janë:

Për një largësi mbi 100 km nga gjykata ku është thirrur për të dëshmuar, i paguhen shpenzimet e mëposhtme:

1. Dietë ditore në masën jo më shumë se 2500 lekë në ditë
2. Shpenzimet e fjetjes kundrejt dokumentit tatimor përkatës, në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore, të paraqitura nga hoteli shoqëruar me kuponin tatimor, por jo më shumë se 3 mijë lekë për çdo natë
3. Shpenzimet e transportit kundrejt dokumentit tatimor përkatës në bazë të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.
4. Kur dëshmitari largohet nga vendi i punës, shpërblehet në vlerë të barabartë me pagën ditore të ndërprerë. Shpërblimi kërkohet nga dëshmitari me anë të paraqitjes së një dokumenti me karakter vërtetues të vendit të punës dhe vlerës së pagës
5. Në udhëzim përcaktohen edhe shpërblimet dhe pagesat e ekspertëve gjatë procesit gjyqësor. Pagesa e dietave është e njëjtë me atë të dëshmitarëve për një largësi mbi 100 kilometër ndërsa fiksohet tavan i pagesës së ekspertizës, e cila duhet të jetë jo më shumë se 40000 lekë.

Ky udhëzim nuk u bëhet me dije dëshmitarëve nga askush, çka kuptohet me shifrat minimale që kanë shpenzuar, të paktën Gjykata për Krime të Rënda dhe Gjykata e Tiranës për këtë qëllim.

Të dhëna nga Gjykata e Shkallës së Parë të Krime të Rënda dhe në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë flasin për nivele ekstremisht minimale të pagesës së dëshmitarëve. Kështu, për vitin 2013 Gjykata për Krime të Rënda ka paguar dietën e dy dëshmitarëve në shumën 1600 lekë. Ndërsa për vitin 2014 nuk është paguar asnjë i tillë. E njëjta gjendje paraqitet edhe në Gjykatën e Tiranës, kur gjatë vitit 2013 është paguar vetëm një dëshmitar me 1200 lekë. Për vitin 2014 nuk është regjistruar asnjë pagesë dëshmitari. Për shkak se nuk kanë dijeni se mund të përfitojnë diçka, në pamundësi financiare, një pjesë e mirë e dëshmitarëve nuk janë të interesuar t’i përgjigjen thirrjes së gjykatës. Mosparaqitja bëhet shkak më pas për shtyrje të herëpashershme dhe zvarritje të proceseve gjyqësore.

Monitoruesi ka konstatuar se dëshmitarët nuk kanë dijeni për këtë vendim, ose kanë pjesërisht dijeni. Shumica e dëshmitarëve të kontaktuar shprehën se kanë dijeni për pagesat e biletave të udhëtimit dhe dietës ditore por jo edhe të shpenzimeve të punës që kanë lënë pa bërë për shkak të pjesëmarrjes në gjyq.

Përgjatë procesit të monitorimit u kontaktuan 23 dëshmitarë në procese kryesisht penale. Shtatë prej tyre vinin nga zona me largësi 100 km nga Tiranë. Gjashtë nga këta

dëshmitarë nuk e njihnin udhëzimin e qeverisë për shpërblimin e dëshmitarëve. Pesë prej tyre kishin dijeni se mund të paguhej vlera e biletës, por vetëm njëri prej tyre kishte biletë. Tre nga dëshmitarët prisnin të paguhej edhe dieta, por nuk njihje vendimin. Një nga dëshmitarët nuk ia kishte idenë e këtyre pagesave.

## **Gjetjet**

1. Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr.5668, dt.20.11.2013 lehtëson dukshëm aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë dhe rrit barazinë në marrjen e shërbimeve të gjykatave të shkallës së parë.
2. Shpenzimet për kryerjen e veprimeve procedurale janë të larta. Kosto më e lartë krijohet nga ekspertët, avokatët dhe përmbauesit.
3. Në gjykata ende ka vendime gjyqësore të ndryshme për të njëjtën çështje. Parimi i precedentit nuk zbatohet si një normë tashmë e njohur e gjykimit. Kjo con në shpërndarjen e së drejtës në mënyrë të pabarabartë.
4. Nuk përcaktohen afatet e shpërblimit në udhëzimin e qeverisë të vitit 2012 për shpërblimin e dëshmitarëve dhe ekspertëve
5. Ka probleme të llogaritjes së shpenzimeve të transportit, pasi ato i referohen cmimeve të shërbimit publik, ndërkohë që ka diferenca në këto cmime.
6. Ka burokraci në procedurat e shpërblimit të dëshmitarëve.
7. Dëshmitarët në përgjithësi nuk e njohin udhëzimin e qeverisë, edhe pse dinë disa prej pagesave që sigurohen nga ky udhëzim.

## **Rekomandimet**

1. Ndryshimet ligjore jashtë fushës së drejtësisë që prekin aksesin në drejtësi duhet të konsultohen më grupet e interesit, rasti i ndryshimit të ligjit mbi taksat ka cenuar barazinë e qytetarëve në të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e gjykatës.
2. Ulja e tarifave për marrjen e shërbimeve në gjykatë duhet të shoqërohet me stabilizimin e cmimeve për shërbime që i ofrohen gjykatës dhe palëve në proces përgjatë seancave gjyqësore. Duhet rikonsideruar pagesat e ekspertëve.
3. Pas një procesi konsultimi dhe diskutimi duhet hartuar vendime dhe akte të tjera nënligjore përmes të cilave gjykatësit duhet të përjashtohen nga vlerësimi i kostove të ekspertit apo kostove të tjera. Në vijim, kostot e ekspertëve duhet të përcaktohen nga qeveria, pas një studimi të thellë lidhur me tregun e ekspertëve dhe koston e produktit të tyre sipas llojit.
4. Gjykatat duhet të përmirësojnë tërësisht procedurat e pagesës së dëshmitarëve
5. Mundësimi i pagesës së dëshmitarëve fill pas procesit gjyqësor dhe lajmërimi i kësaj pagese nga gjykatësi apo sekretaria e gjykatës
6. Vendosija e lajmërimeve për shpërblimin në vende të dukshme të gjykatës apo në sallën e gjykimit
7. Llogaritja e një kosto reale të thirrjes së dëshmitarëve nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor

### **Pjesa III. Monitorimi i ankesave online:**

Në progres raportin e Bashkimit Evropian për vitin 2013 përmenden dy prej produkteve të projekteve të mbështetura nga ambasada britanike dhe implementuar nga Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë. Së pari bëhet fjalë për memorandumin e bashkëpunimit mes KLD dhe Ministrisë së drejtësisë për shmangien e mbivendosjes, ku QTIL përgaditi një ekspertizë e cila shërbeu si bazë për këtë memorandum dhe raporti i KE e vlerëson si një bashkëpunim tashmë pa probleme, së dyti lidhur me efektivitetin e ankesave online për gjyqësorin, ku nga progres raporti kërkohej që të vlerësohej ky efektivitet.

QTIL ka implementuar në vitin 2012 ankimimin online dhe menaxhimin dixhital të animimeve në ministrinë e Drejtësisë dhe KLD. Gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 dhe gjahstë mujave të parë të vitit 2013, rreth 20 për qind e ankesave janë kryer në rrugë digjitale, duke mundësuar zgjedhjen e ankesave të qytetarëve brenda një kohe të shkurtër. Koha e përgjigjes për ankesën në rrugën digjitale është pesë ditë nga 10-360 ditë që ka qënë në rrugë manuale.

#### **Ankimimi online në KLD**

Duke patur parasysh se ende kishte nevojë që të përmirësohej menaxhimi digjital dhe të rritej transparenca e këtij menaxhimi duke shtuar kështu besimin e qytetarëve tek administrata e drejtësisë për një procedim të drejtë, transparent dhe të shpejtë të ankesave, projekti synoi që të bënte një përshtatje të menaxhimit dixhital të ankesave me organizimin e ri të KLD-së, ku inspektorëve u jepej akses në ankimimin online, si dhe pasqyrimin ndryshimeve në gjykata, ngritja e gjykatave administrative, ndryshimi i numrit të gjyqtarëve në gjykata. Më pas të hartohet në konsultim mes zyrtarëve të KLD dhe ekspertëve të qendrës, një guidë e gjurmimit të ankesave online e cila do të instalohej në softin e ankesave online dhe përmes të cilës qytetarët të shohin rrugën e procedimit të ankesës së tyre.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë gjatë vitit 2013 dhe tremujorit të parë të vitit 2014 ka trajtuar 750 ankesa për gjyqtarët, nga ku në 15 prej tyre ka pasur shkelje dhe materialet e kontrollit i janë dërguar Ministrisë së Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, si i vetmi organ, i cili mund të iniciojë procedimin disiplinor në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në total, duke përfshirë edhe ankesat e vitit 2012, KLD ka dërguar në Ministrinë e Drejtësisë 20 kërkesa për 14 gjyqtarë.

Për 67 gjyqtarë të Shkallës së Parë dhe të Apelit, pas konstatimit të parregullsive të ndryshme të kryera, i është tërhequr vëmendja me shkrim. Nga të cilat 19 raste janë bërë bazuar në ankesat e ardhura në vitin 2011, 15 raste janë bazuar në ankesat e ardhura në vitin 2012, dhe siç thamë më lart, 33 raste janë për ankesat e ardhura gjatë vitit 2013.

325 ankesa janë arkivuar, pasi nga vlerësimi paraprak është konstatuar se janë të pabazuara për arsye se:

- objekti i tyre, pretendimi i ngritur në ankesë, është jashtë kompetencës dhe veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë (ankesa ndaj institucioneve jo gjyqësore)
- janë ankesa të cilat duhet të ndiqen nga qytetari në rrugë ankimore në gjykatën kompetente gjë për të cilën Këshilli (inspektorati) nuk mund të ndërhyjë.

-për 56 raste janë evidentuar shkelje shumë të lehta, të cilat nuk përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor. Për këto raste është vendosur që të mbahen parasysh gjatë vlerësimit profesional dhe etik të gjyqtarëve.

- për 23 raste pas verifikimit është konstatuar se nuk ka shkelje nga ana e gjyqtarëve.

-122 ankesa janë në proces vlerësimi paraprak nga inspektorët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas akteve që rregullojnë funksionimin e Inspektoriatit, në përfundim të shqyrtimit inspektorati mund të vendosë:

- kthim përgjigje për qytetarët,

- arkivimin e ankesës pasi nuk ekzistojnë elementë të mjaftueshëm për të filluar një kontroll

- verifikimin e rastit

Për periudhën e marrë në shqyrtim Këshilli i ka referuar për kompetencë institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme, 7 praktika që konsistojnë në raste të denoncuar nga publiku dhe për të cilat inspektorati i KLD nuk ka kompetencë ligjore t'i hetojë.

Ankimimi online në KLD nuk ka funksionuar në rregull. Punonjësit e trainuar nga QTIL me fillimin e projektit të ri prej saj, nuk ishin më në zyrën e trajtimit të ankesave të qytetarëve dhe ndërkohë përgjatë transferimit të të dhënave të faqes se KLD tek Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, softi i ankesës online ishte dëmtuar.

Gjatë vitit 2012, KLD pësoi ndryshime të thella në organizimin e brendshëm si rezultat i ndryshimit të nënkryetarit të KLD-së dhe një pjese të stafit drejtues, pas dorëheqjes së nënkryetarit të mëparshëm. Po ashtu duke i dhënë rëndësi ankimit online, drejtuesit e inspektoratit, kërkuan që edhe inspektorët të konsolidonin mënyrën e re të trajtimit të ankesës nëpërmjet menaxhimit digjital të saj.

Kështu që QTIL u ndodh përpara disa sfidave:

-rishikimit të menysë digjitale,

-setup të plotë për të gjithë menaxhimin digjital,

-trainimit të stafit të ri dhe inspektorëve


-asistencës përgjatë procedimeve të para të menaxhimit digjital të ankesës

-dhe më pas projektimit dhe implementimit të gjurmimit (tracking) të ankesës online ndaj gjyqësorit.

Përgjatë shtatë muajve, stafi i ngarkuar më këtë objektivi të projektit ka zhvilluar në KLD:

-15 takime konsultuese, prej të cilave, një me nënkryetarin e KLD-së, 5 me

*Përmbledhje e shkurtër e komunikimit elektronik mes stafit të QTIL dhe atij të KLD:*



Kryeinspektoren e lartë të KLD-së dhe 9 konsultime të tjera me stafin teknik dhe stafin tjetër të inspektimeve në KLD. Po ashtu ka pasur komunikim elektronik dhe me telefon, të përjavshëm dhe ndonjëherë edhe disa herë në javë për kooperimin e punës mes stafit të QTIL dhe KLD.

Përgjatë këtyre konsultimeve janë evidentuar problematikat, nevojat për rishqyrtim dhe përshtatje me format e reja të organizimit dhe kontrollit të KLD. Po ashtu pavarësisht vështirësive teknike dhe burokratike nga zyrtarët e administratës të cilat zgjatën më shumë se tre muaj u arrit përshtatshmëria e ndryshimeve në KLD me kërkesat e AKSHI-t.

Stafi teknik i QTIL implementoi ndryshimet ne soft që kishin të bënin me gjykatat e reja, emrat e rinj të gjykatësve, pasqyrimin e transferimeve dhe emërimeve të reja si dhe kërkesa të tjera nga ana e drejtuesve të KLD-së, që lidheshin me mënyrën e menaxhimit të brendshëm të inspektoratit të kontrollit të gjyqësorit.

Janë mbyllur trainimet me stafin e regjistrimit të ankesave si dhe më inspektorët e KLD-së.

Janë zhvilluar dy trainime me punonjësit e zyrës së regjistrimit të ankesave dhe inspektorët sipas modulit të mëposhtëm:

Nr.	Pershkrimi	Roli
<b>Ankesa Online</b>		
1	Demonstrimi i Regjistrimit te Ankeses Online <a href="http://kld.al/kld_ankesa/">http:// kld.al/kld_ankesa/</a>	
<b>Sistemi i Administrimit te Ankesave</b>		
1	Regjistrimi i Ankesave online ne sistem – Roli “Regjistrues”	Regjistrues
2	Regjistrimi i Ankesave te tjera ne sistem	Regjistrues
3	Regjistrimi i Urdherit nga Kryeinspektori	Kryeinspektor
4	Regjistrimi i Informacionit te Inpektorit	Inspektor
5	Regjistrimi i Relacionit te inspektorit	Inspektor
6	Aprovim nga Kryeinspektori	Kryeinspektor
7	Aprovim nga nenkryetari	Nenkryetar
8	Pergatitja e Dokumentacionit per Ankesen	Specialist

Fotot gjatë trainimit të stafit të KLD-së:







Aktualisht QTIL ka gati variantin përfundimtar të guidës së gjurmimit të ankesës online nga qytetarët e cila është konvertuar gjithashtu në soft e gatshme për t'u instaluar në serverin e KLD-së, sapo stafi i brendshëm do të jetë gati për të përpunuar në mënyrë dixhitale ankesat online. Pritet që implementimi të ndodhë brenda pak javësh.

Stafi i QTIL ka kryer katër konsultime me drejtues dhe ekspertë të KLD lidhur me guidën dhe softin e tracking dhe hartimi i guidës ka kaluar në disa faza dhe ndryshme deri në përputhjen e interesave të publikut dhe aftësisë së stafit të KLD-së për të lënë gjurmët e përpunimit të ankesës e cila do të ti nisët automatikisht qytetarëve që kanë aplikuar përmes dritares së ankesave online në faqen elektronike të KLD-së.

### ***Skema përfundimtare e guidës së tracking:***

#### **Regjistrimi**

KLD - regjistrim i ankeses online

Emri i ankuesit:	alban
Mbiemri i ankuesit:	hasa
Adresa:	tirane 1234
Nr. Tel:	256478
Email:	albanhasa@gmail.com
Data e plotësimit të formularit:	25/3/2014
Ankohesh për here të parë:	Po
Ankimi për gjyqtarin:	ddfff
Në Gjykatën e Shkallës së Parë:	Tirane
Ankesa për: Padi civile :	
-Shkaqet e ankesës:	
Padipenale :	
-Shkaqet e ankesës:	
Cështja gjyqësore:	

Nr. Cështjes gjyqësore:

Palë ne proces:

Data e zhvillimit te gjyqit që ankohet:

Nëse gjyqi është në gjykatën e shkallës së parë:

Nëse po:

Cështja gjyqësore:

Nr. Cështjes gjyqësore:

Synimi i ankesës:

---

Inderuar qyterar, ju njoftojmë që ankesa juaj u regjistrua. Klikoni këtu për të kontrolluar statusin e ankesës tuaj.

Klikoni këtu për të ndjekur statusin e kësaj ankesë.

Nëse linku i mësipërm nuk punon, ju lutem itë kopjoni adresën e mëposhtme dhe hapeni atë me broëser-in tuaj të preferuar!  
[http://kld.local/kld\\_ankesa/index.php?crd=13&token=c829f82e8723b1ff1cda906f76a794f4d48525fa](http://kld.local/kld_ankesa/index.php?crd=13&token=c829f82e8723b1ff1cda906f76a794f4d48525fa)

---

Ju do tënjofroheni me e-mail (nëadresën e regjistruar) në castin që kërkesa juaj do të merret në dorëzim. Më sipër janë paraqitur të dhënat e plota të kërkesës që sapo regjistruat. Ju faleminderit!

---

Ky është një mesazh i gjeneruar automatikisht dhe nuk keni nevojë t'i përgjigjeni.

## **2- Kërkesa per rikuperim**

Kërkesë për rikuperimin e adresës

---

Inderuar qyterar, ju keni bërë një kërkesë për rikuperimin e adresës së monitorimit të ankesave.

Klikoni këtu për të parë listen e plotë të ankesave qe janë regjistruar nga ju.

Nëse linku i mësipërm nuk punon, ju lutem itë kopjoni adresën e mëposhtme dhe hapeni atë me broëser-in tuaj të preferuar!  
[http://192.168.1.114/kld\\_ankesa/index.php?crd=13&token=0c2a3d5c76eb2d169b3218805c600dd79e2eaa71&st=list](http://192.168.1.114/kld_ankesa/index.php?crd=13&token=0c2a3d5c76eb2d169b3218805c600dd79e2eaa71&st=list)

---

Ky është një mesazh i gjeneruar automatikisht dhe nuk keni nevojë t'i përgjigjeni.

## **3. Ndryshimi i Statusit**

### **3.1Dorezimi**

Inderuar qyterar, ju njoftojmë që ankesa juaj paraqitur pranë KLD nëpërmjet sistemit të ankesave online, është azhornuar.

Ankesa juaj u mor ne dorezim ne Sistemin e Ankesave. Numri i regjistrimit eshte: 557

Klikoni këtu për të parë detajet e ankesës tuaj.

Nëse linku i mësipërm nuk punon, ju lutem itë kopjoni adresën e mëposhtme dhe hapeni atë me broëser-in tuaj të preferuar!  
[http://192.168.1.114/kld\\_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c](http://192.168.1.114/kld_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c)

---

Ky është një mesazh i gjeneruar automatikisht dhe nuk keni nevojë t'i përgjigjeni.

### 3.2 Regjistrimi

Inderuar qytetar, ju njoftojmë që ankesa juaj paraqitur pranë KLD nëpërmjet sistemit të ankesave online, është azhurnuar.

Ankesa juaj u regjistrua ne Sistemin e Ankesave! Numri i regjistrimit është: 557

Klikoni këtu për të parë detajet e ankesës tuaj.

Nëse linku i mësipërm nuk punon, ju lutemi të kopjoni adresën e mëposhtme dhe hapeni atë me broësërin tuaj të preferuar!  
[http://192.168.1.114/kld\\_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c](http://192.168.1.114/kld_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c)

---

Ky është një mesazh i gjeneruar automatikisht dhe nuk keni nevojë t'i përgjigjeni.

### 3.3-Perfundim

Inderuar qytetar, ju njoftojmë që ankesa juaj paraqitur pranë KLD nëpërmjet sistemit të ankesave online, është azhurnuar.

Ankesa juaj përfundoi

Klikoni këtu për të parë detajet e ankesës tuaj.

Nëse linku i mësipërm nuk punon, ju lutemi të kopjoni adresën e mëposhtme dhe hapeni atë me broësërin tuaj të preferuar!  
[http://192.168.1.114/kld\\_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c](http://192.168.1.114/kld_ankesa/index.php?crd=13&token=49e7e7153e1ae553fb8ac8cfb963de56dbd7d24c)

---


Ky është një mesazh i gjeneruar automatikisht dhe nuk keni nevojë t'i përgjigjeni.


## Monitorimi i ankesave online në ministrinë e Drejtësisë

Numri i ankesave online në ministrinë e Drejtësisë deri në shtator të vitit 2013 shkoi në rreth 600 të tilla nga të cilat ankesa të realizuara online ishin 140 ose rreth 25 për qind e totalit të ankesave.

Portali i ankimeve online në ministrinë e Drejtësisë ndryshoi fokusin me 23 shtator 2013. Që prej asaj periudhe e deri më në mesin e muajit maj 2014 janë bërë 760 ankesa.


Janë trajtuar 560 ankesa dhe janë në proces verifikimi ankesat e tjera. Nga ankesat e trajtuara rezultojnë se objekti i tyre adreson problematikat e ndeshura nga qytetarët në gjykata (270 ankesa); prokurori (100 ankesa); profesionet e lira; noteri, përmbarim privat dhe avokati (75 ankesa) dhe nga agjensitë e trajtimit të çështjeve të pronësisë (115 ankesa).





Në bazë të informacionit të përcjellë Ministria e Drejtësisë ka kryer verifikime dhe ka ushtruar inspektime pranë subjekteve objekt të këtyre denoncimeve.

Eshtë ushtruar inspektim pranë 3 prokurorive të rretheve gjyqësore (Tiranë, Vlorë dhe Elbasan), për verifikimet e vendimeve të mosfillimit të procedimit apo pushimit të çështjes. Gjatë këtyre inpektimeve janë verifikuar 10 procedime penale, të cilat përfshijnë veprimtarinë e 8 prokurorëve. Në përfundim të inspektimeve janë konstatuar shkelje të dispozitave procedurale ligjore nga ana e 2 prokurorëve për të cilët janë përcjellë rekomandimet përkatëse pranë Prokurorit të Përgjithshëm. Gjithashtu, është ushtruar inspektim pranë zyrave noteriale dhe zyrave përmbarimore gjyqësore private. Në përfundim të inspektimit, është rekomanduar fillimi i procedimit disiplinor ndaj përmbaruesve gjyqësorë privatë.



Ministria e Drejtësisë, ka pasur bashkëpunim me institucionet ligjzbatuese, si me Prokurorinë e Përgjithshme (pranë së cilës janë përcjellë për verifikim 18 denoncime),

me Inspektoriatin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive (pranë së cilës ka përcjellë për verifikim 2 denocime), si dhe me institucione të tjera të përfshira në luftën kundër korrupsionit.

Në ministrinë e Drejtësisë u shënuan ndryshime në mënyrën e menaxhimit dhe trajtimit të portalit të ankesave online.

Portali i ankesa për gjyqësorin zgjeroi shërbimet e tij duke pranuar ankesa për të gjithë sektorët apo institucionet që varen nga ministria e Drejtësisë. Në njoftimin që shoqëron portalin thuhet: “Denonco korrupsionin, denonco shkeljet e ligjit, denonco sjelljet që bien ndesh me etikën profesionale, denonco rastet e fshehjes së pasurisë së: Gjyqtarëve, Prokurorëve, si dhe çdo nëpunësi që ushtron detyrën në: Zyrat e përmbarimit shtetëror ose privat, Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe Institucionet e ekzekutimit të dënimeve penale, Agjencinë e Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Shërbimin e Provës, Noteri, Avokaturën e Shtetit dhe zyrat vendore, Institutin e Mjekësisë Ligjore, Komisionin Shtetëror të Ndihmës Juridike, Komitetin Shqiptar të Birësimit, Institutin e Integritetit të Përndjekurve Politikë, Qendrën e Publikimeve Zyrtare, Agjencinë e Mbikqyrjes së Falimentit dhe administratorëve të falimentit”.

Ndërkohë njoftimi për shtyp i 23 shtatorit 2013 theksonte ndër të tjera se “në mënyrë që monitorimi i sistemit të drejtësisë të jetë sa më transparent, portali i Ankesave Online tashmë vjen i ndryshuar nën emërtimin “Stop Korrupsionit në Drejtësi” dhe më i eficient. Ky projekti, që deri më sot ka patur si qëllim denoncimin e rasteve të shkeljeve vetëm ndaj gjyqtarëve në të gjitha shkallët e gjyqësorit, tashmë zgjeron fushën e ankesave deri tek çdo nëpunës që ushtron detyrën në të gjitha zyrat dhe institucionet që kanë varësi nga Ministria e Drejtësisë”.

Sipas ministrisë së Drejtësisë, fokusi i ankesës online ka qënë i kufizuar, vetëm për gjyqtarët, ekipi i këshilltarëve dhe specialistëve përkatës kanë punuar për ta zgjeruar fushën e ankimimeve.

Më 3 tetor 2013 portali u bllokua nga Komisioneri për të dhënat personale pas ankesave të qytetarëve për publikimin e të dhënave të tyre në faqen online të ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë me këtë rast nxori një shënim në vend të portalit ku thuhet se “Ju kërkohet ndjesë për ndërprerjen e aplikimeve të denoncimeve në portalin “Stop Korrupsionit në Drejtësi”, për shkak të vendimit të ndërmjetëm numër 1, datë 1.10.2013, të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka vendosur bllokimin dhe pezullimin e këtij shërbimi. Në respekt të frymës së zbatimit të ligjit, jemi të detyruar që kundër vullnetit tonë të palëkundur në luftën kundër korrupsionit, të ndërpresim përkohësisht këtë shërbim.”

Më 17 tetor portali nisi sërish transmetimet duke fshehur një pjesë të të dhënave, por pa ndonjë ndryshim thelbësor. Ndërkaq më 2 prill 2014 ai rifilloi me të dhëna të plota për të gjithë aplikuesit që pranorin të paraqitinin të dhënat e tyre në pjesën e lexueshme të animimit: “Nëpërmjet paraqitjes së këtij denoncimi, njëkohësisht jap pëlqimin që të dhënat e mia personale, pjesë e këtij denoncimi të publikohen në portalin online në faqen tuaj”.

Ky shënim shoqërohet me një faqe tjetër në të cilën shpjegohen arsyet e publikimit të të dhënave dhe konfirmohet pëlqimi për publikimin: “Termat e përpunimit. Unë kontrolluesi Ministria e Drejtësisë në përputhje me ligjin Nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, informoj se të dhënat e mbledhura nga ju

si subjekte të të dhënave personale, do të përdoren me qëllim bërjen transparente të korrupsionit në raste e çështje të ndryshme të dërguar nëpërmjet denoncimit online...  
...Përhapja e të dhënave do të bëhet vetën nëse do të jetë absolutisht e nevojshme për përmbushjen e shërbimit të kërkuar ose nëse kontrolluesi kryen një përpunim që është thelbësor për përmbushjen e një detyrimi ligjor.

Unë (subjekti i të dhënave) pas marrjes së informacionit të detajuar në lidhje me natyrën, dhe rëndësinë e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi Ministria e Drejtësisë si dhe pas marrjes së informacionit të detajuar mbi të drejtat e mia të parashikuara në ligj, jap pëlqimin tim të lirë që të dhënat e mia që më bëjnë mua të identifikueshëm, të publikohen në portalin online në faqen tuaj.”

Ndërkaq në Konferencën Gjyqësore që u mbledh në 18 prill 2014 u hartua një rezolutë që sërish kishte lidhje me përmbajtjen e publikuar në portalin e faqes elektronike të Ministrisë së Drejtësisë. Përmes rezolutës ata i kërkojnë Ministrisë së Drejtësisë që të mos publikojë denoncime të qytetarëve pa i verifikuar. Ndër të tjera në rezolutë thuhet se “Konferenca i kërkon Ministrisë së Drejtësisë që, krahas nxitjes dhe marrjes së informacionit dhe denoncimeve nga publiku, të marrë masat e menjëhershme për të parandaluar publikimin e denoncimeve, pa u verifikuar më parë vërtetësia e tyre nga strukturat e inspektimit”, thuhet në rezolutë.

Lidhur me ndryshimet në portalin e ankesës online në Ministrinë e Drejtësisë, QTIL njoftoi edhe Ambasadën britanike nëpërmjet një letre drejtuar asaj tre ditë pas ndryshimeve në portal, më 26 shtator të vitit 2013. Në letër ndër të tjera thuhet se QTIL duke vlerësuar nismën e Ministrisë së Drejtësisë për të luftuar korrupsionin në të gjitha hallkat e saj thekson se zgjerimi i shërbimeve të portalit e devijon atë nga qëllimi për të cilin është ndërtuar. Portali është një shërbim për qytetarët dhe jo një platformë denoncimi. Ankimimi online zvogëlon në minimum kohën e mbërritjes së ankesës nga qytetari në institucionin përkatës. Ankimi administrimet nga zyrat përkatëse në mënyrë dixhitale duke zvogëluar kohën e shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së përgjigjes së qytetarit rreth vlerësimit mbi ankesën.

Ankimimi online zhdok plotësisht apo zvogëlon kontaktet mes zyrtarëve publikë që administrojnë ankesën dhe qytetarëve në kohën e aplikimit dhe administrimit të ankesës. Reduktimi i kontakteve zyrtar publik-qytetar në momentin e marrjes së shërbimeve zvogëlon mundësitë e incidencës së korrupsionit. Ankimimi online orienton dërgimin e ankesave për gjyqësorin direkt tek institucionet që e kanë detyrim ligjor trajtimin e tyre duke shmangur vonesat në dërgimin e ankimeve tek Avokati i Popullit, Presidenca, Parlamenti apo Qeveria.

Sikurse theksohet në këtë letër, zgjerimi i shërbimeve të ankimit online nxjerr jashtë funksionit zonën e administrimit dixhital, një implementim tjetër i QTIL investuar nga ambasada britanike.

Administrimi digital krijon lehtësira në administrimin e ankimit duke kyrsyer kohë dhe ndërkohë lë gjurmë i gjithë procesi i shqyrtimit duke shmangur procedura burokratike.

Ai lehtëson komunikimin mes MD dhe KLD për konsultimet lidhur me shmangien e mbivendosijes përgjatë kontrollit të gjyqësorit për shkak të ankesave të qytetarëve. Nga data e krijimit të portalit deri në shkurt të vitit 2013 rreth 25 për qind e ankesave ndaj gjyqtarëve u bënë online, shifër e konsiderueshme për një kohë aq të shkurtër.

Sugjerojmë Ministrisë së Drejtësisë të mbajë të hapur dhe të vecuar platformën e ankimit online për gjyqtarët për shkak të specifikave të mësipërme, theksohet në këtë letër. Gjatë një takimi zhvilluar mes drejtorit të QTIL dhe ministrit të Drejtësisë më 13 maj 2014, lidhur me disa objektiva të projektit në zhvillim, u bisedua ndër të tjera edhe rreth ndryshimeve në portal. Ministri i Drejtësisë i qëndron idesë se platforma është funksionale dhe konsideron se po përmbushet përgjatë funksionimit të saj edhe qëllimi fillestar i kësaj platforme.

### **Gjetjet:**

1. Ndryshimet në drejtimin e institucioneve kanë cuar në ndryshime të zyrtarëve përgjegjës për ankesat online (KLD)
2. Ka ndërhyrje në portalin online duke e shndërruar funksionin e tij nga një zonë shërbimi në një platformë denoncimi (MD)
3. Ankesat e ardhura në KLD dhe MD janë trajtuar nga zyrat përgjegjëse dhe më pas janë referuar sipas cilësisë së tyre, në gjykatë, në prokurori, në KLD. 4.
4. Ankesat online të qytetarëve kanë ulur në mënyrë shterruese kohën e ardhjes së ankesës në institucion (në cast) dhe kohën trajtimit të këtyre ankesave (shumica në një kohë më të shkurtër se 5 ditë)
5. Të dy institucionet nuk kanë përcaktuar në buxhet shpenzime për mirëmbajtjen e portaleve dhe zonës së menaxhimit të tyre. Për këtë shkak probleme që mund të lindin në sistem mund të bllokojnë funksionimin e tij. Shpesh problemet janë të tilla që nuk përballohen nga zyrat e IT së institucioneve përkatëse.

### **Rekomandime:**

1. Ministria e Drejtësisë duhet të ndajë platformën antikorrupsion me portalin e ankesave ndaj gjyqësorit duke i trajtuar ato si dy mënyra të ndryshme të ofertës së ministrisë ndaj problematikave që shqetësojnë qytetarët
2. Në të dy institucionet, KLD dhe Ministrinë e Drejtësisë duhet të shmangen lëvizjet e shpeshta të personelit të trainuar për menaxhimin ankesave online për shkak të kostos së trainimit dhe kostos së cilësisë së punës
3. Të dy institucionet duhet të parashikojnë në buxhet shpenzimet për mirëmbajtjen e portalit

## IV: Gjetjet dhe rekomandimet e monitorimit

### Gjetjet:

1. Gjyqet shtyhen në: 18 për qind të rasteve për shkak të mungesës së dëshmitarëve; 13 për qind për shkak se mungoi pala akuzuese; 13 për qind se mungoi prokurori; 10 për qind se munguan të dy palët; 12 për qind sepse mungoi avokati; 6 për qind për mungesë të gjyqtarit; 12 për mungesë të palës paditëse; 4 për qind për mungesë të ekspertit; 6 për qind për mungesë dokumentash; 6 për qind për mungesë të tarifës.
2. Shtyrja e gjyqeve është më e qëndrueshme në rastet e gjyqeve për çështjet civile se sa për ato penale. Kjo për shkak se adresat e dëshmitarëve janë më të stabilizuara, lidhja e tyre me procesin gjyqësor është më madhe për shkak të procesit hetimor pasi në proces ose përgaditjen e procesit përfshihen shumë struktura si ato të policisë, hetimit dhe gjykatës.
3. Shtyrja e gjyqeve për shkak të avokatëve është një mit. Avokatët shtyjnë gjyqe vetëm në ato raste kur mungesa e tyre përbën taktikë (rasti i gjyqit të Dritan Dajtit, janë zhvilluar 280 seanca deri tani).
4. Një numër i konsiderueshëm i gjyqeve shtyhen për shkak të mungesës së prokurorëve
5. Numri i proceseve gjyqësore për çështje që kalojnë një vit ka ardhur në rritje. Ndërkaq monitorimi ka treguar se çështjet që shkojnë nga 6 muaj deri në 9 muaj kanë rënë. Po ashtu ka një rënie të lehtë nga viti 2012 e në vijim edhe për çështjet me një kohë më të vogël të procesit nga 1 ditë deri në 2 muaj, nga 2 muaj deri në 6 muaj.
6. Lajmërimi i dëshmitarëve dhe palëve mbetet një sfidë për administratën e gjykatave. Rreth 60 për qind e adresave të palës së paditur nuk gjinden, vetëm 40 për qind e tyre janë të sakta.
7. Administrata e gjykatave nuk shfrytëzon mundësi të tjera për eksplorimin e adresave sic është regjistri i votuesve, regjistri i gjendjes civile.
8. Ftesat e dëshmitarëve shpesh herë bëhen në mënyrë triviale, duke porositur palët në gjyq.
9. Thirrja e dëshmitarëve dhe palëve mbetet në fund përgjegjësi e gjykatësit i cili nuk ka as kohën dhe as mjetet e nevojshme për të realizuar thirrjen e tyre.
10. Numri i ftuesve në gjykatë është i pamjaftueshëm dhe ndërkaq ndonjëherë ndodhen edhe në kushtet e konfliktit të interesit. Nuk janë të azhornuar me mjetet e reja për gjetjen e adresave.
11. Dëshmitarët apo palët në proces nuk njoftojnë gjykatën për mungesën e tyre duke shkaktuar ndër të tjera edhe rritje të kostos së procesit gjyqësor
12. Kur gjyqtarët apo prokurorët mungojnë, ata nuk njoftojnë në kohë duke shtuar koston e shpenzimeve për gjyqin të dëshmitarëve apo palëve në proces.
13. Nuk ka penalitete për ata që nuk paraqiten në seancat gjyqësore.
14. Nuk ka asnjë iniciativë nga gjykatat apo institucionet e drejtësisë për të mbushur këtë boshllëk ligjor i cili inkurajon frekuentimin e dobët të seancave gjyqësore prej dëshmitarëve.



15. Njoftimi nëpërmjet shpalljes së gjykimit, edhe pse ligjor, përbën shkelje të së drejtës së qytetarëve për t'u lajmëruar për çështje trajtojnë interesa që lidhen ose i përkasin atij.
16. Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr.5668, dt.20.11.2013 lehtëson dukshëm aksesin në drejtësi të shtresave në nevojë dhe rrit barazinë në marrjen e shërbimeve të gjykatave të shkallës së parë.
17. Shpenzimet për kryerjen e veprimeve procedurale janë të larta. Kosto e lartë krijohet nga ekspertët, avokatët dhe përmbaruesit.
18. Në gjykata ende ka vendime gjyqësore të ndryshme për të njëjtën çështje. Kjo con në shpërndarjen e së drejtës në mënyrë të pabarabartë
19. Në udhëzimin e qeverisë të vitit 2012 nuk përcaktohen afatet e shpërblimit të dëshmitarëve dhe ekspertëve për pjesëmarrjen e tyre në seanca gjyqësore
20. Ka probleme të llogaritjes së shpenzimeve të transportit, pasi ato i referohen cmimeve të shërbimit publik, ndërkohë që ka diferenca në këto cmime mes shërbimit publik dhe atij privat, gjerësisht i përdorur.
21. Procedurat e shpërblimit të dëshmitarëve në gjykata janë burokratike dhe mungon transparenca.
22. Dëshmitarët në përgjithësi nuk e njohin udhëzimin e qeverisë, në pak raste dinë disa prej pagesave që sigurohen nga ky udhëzim.
23. Ndryshimet në drejtimin e institucioneve kanë cuar në ndryshime të zyrtarëve përgjegjës për ankesat online (KLD)
24. Ka ndërhyrje në portalin online duke e shndërruar funksionin e tij nga një zonë shërbimi për qytetarët në një platformë denoncimi (MD)
25. Ankesat e ardhura në KLD dhe MD janë trajtuar nga zyrat përgjegjëse dhe më pas janë referuar sipas cilësisë së tyre, në gjykatë, në prokurori, në KLD
26. Ankesat online të qytetarëve kanë ulur në mënyrë shterruese kohën e ardhjes së ankesës në institucion (në cast) dhe kohën e trajtimit të këtyre ankesave (shumica në një kohë më të shkurtër se 5 ditë)
27. Të dy institucionet nuk kanë përcaktuar në buxhet shpenzime për mirëmbajtjen e portaleve dhe zonës së menaxhimit të tyre. Për këtë shkak probleme që mund të lindin në sistem mund të bllokojnë funksionimin e tij. Shpesh problemet janë të tilla që nuk përballohen nga zyrat e IT së institucioneve përkatëse.

## **Rekomandime**

1. Gjykatat duhet të transformojnë sistemin e lajmërimit të dëshmitarëve dhe palëve në proces kur atë e kryejnë vetë, përmes modernizimit të mjeteve të njoftimit dhe përdorimit të mjeteve të reja të komunikimit sidomos të hartave dixhitale
2. Gjykatat duhet të përdorin shërbimet e postës shqiptare në mënyrë më të shpeshtë duke parashikuar në buxhet një fond për shpenzime për postën, si edhe për shërbimeve e avancuara të postës sic është njoftimi dixhital që eliminon mundësinë e refuzimit të thirrjes por edhe mund të kontrollhet procesi nëpërmjet gjurmimit të njoftimit dhe depozitimit të të dhënave të njoftimit në serverin e aksesueshëm të postës
3. Gjykatat duhet të konsiderojnë ndarjen e njoftimeve mes postës apo shërbimeve të tjera private dhe ftuesve të gjykatës për disa çështje që gjykohej se ftuesit mund

- të kenë konflikt interesi si dhe për çështje të cilat ftuesit nuk kanë arritur të lajmërojnë dëshmitarët apo palët në proces
4. Gjykatat dhe Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor duhet të konsiderojnë seriozisht mundësinë e kontraktimit me një kompani private të thirrjes në tërësi të dëshmitarëve dhe palëve në proces. Kjo ka nevojë për një studim
  5. Në kushtet kur ka munguar deri tani një studim rreth dëmit në aksesin e barabartë të qytetarëve në gjykata për shkak të frekuentimi të dobët të dëshmitarëve dhe palëve, nevojitet një planifikim tërësor për buxhetin e nevojshëm për përmirësimin e procedurave dhe rrugëve të njoftimit, duke mundësuar kështu uljen e kohës së procesit gjyqësor, daljen në kohë të vendimeve të gjykatës.
  6. Gjykatat duhet të hartojnë një rregullore përmes të cilës të parashikohen rastet e shtyrjes së gjyqeve si dhe lajmërimi i palëve për shtyrjen e gjyqit. Sistemi i njoftimeve në gjykatë të jetë i aksesueshëm edhe jashtë gjykatës.
  7. Ndryshimet ligjore jashtë fushës së drejtësisë që prekin aksesin në drejtësi duhet të konsultohen më grupet e interesit. Rasti i ndryshimit të “Ligjit mbi taksat” ka cenuar barazinë e qytetarëve në të drejtën e tyre për të marrë shërbimet e gjykatës.
  8. Ulja e tarifave për marrjen e shërbimeve në gjykatë duhet të shoqërohet me stabilizimin e cmimeve për shërbime që i ofrohen gjykatës dhe palëve në proces përgjatë seancave gjyqësore. Duhet rikonsideruar pagesat e ekspertëve.
  9. Pas një procesi konsultimi me grupet e interesit dhe aktorët në drejtësi duhet hartuar vendime dhe akte të tjera nënligjore përmes të cilave gjykatësit duhet të përjashtohen nga vlerësimi i kostove të ekspertit apo kostove të tjera. Në vijim, kostot e ekspertëve duhet të përcaktohen nga qeveria, pas një studimi të thellë lidhur me tregun e ekspertëve dhe koston e produktit të tyre sipas shërbimit që ofrojnë.
  10. Gjykatat duhet të përmirësojnë tërësisht procedurat e pagesës së dëshmitarëve
  11. Është e domosdoshme mundësimi i pagesës së dëshmitarëve fill pas procesit gjyqësor dhe lajmërimi i kësaj pagese nga gjykatësi në fund të seances gjyqësore apo sekretaria e gjykatës
  12. Vendosija e lajmërimeve për shpërblimin në vende të dukshme të gjykatës apo në sallën e gjykimit rrit shkallën e informimit të dëshmitarëve
  13. Nevojitet llogaritja e një kosto reale të thirrjes së dëshmitarëve nga Zyra e Administrimit të Buxhetit Gjyqësor përmes së cilës parashikohen edhe shpenzimet në ato raste kur i mbeten gjykatës
  14. Ministria e Drejtësisë duhet të ndajë platformën antikorrupsion me portalin e ankesave ndaj gjyqësorit duke i trajtuar ato si dy mënyra të ndryshme të ofertës së ministrisë ndaj problematikave që shqetësojnë qytetarët
  15. Në të dy institucionet, KLD dhe Ministrinë e Drejtësisë duhet të shmangen lëvizjet e shpeshta të personelit të trainuar për menaxhimin e ankesave online për shkak të koston të trainimit dhe koston të cilësisë së punës
  16. Të dy institucionet duhet të parashikojnë në buxhet shpenzimet për mirëmbajtjen e portalit

